



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



ZKA
ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE
NATIONAL AUDIT OFFICE

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË PRISHTINËS PËR VITIN 2024

Prishtinë, qershor 2025

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinion i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA
dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinion i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Komunës së Prishtinës për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2024, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Prishtinës (Komuna e Prishtinës), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2024.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjes/ve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Prishtinës, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme, Ligjin nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësimë dhe ndryshime) dhe Rregulloren MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financier nga organizatat buxhetore.

Baza për Opinion të Kualifikuar

- A1 Llogaritë e arkëtueshme në PVF ishin mbivlerësuar për 30,008€.
- B1 Vlera e detyrimeve kontingjente në PVF ishte mbivlerësuar në vlerë prej 3,886,576€.
- B2 Komuna gjatë ekzekutimit të buxhetit, kishte realizuar pagesa në vlerë 3,907,548€ nga kategori ekonomike joadekuante.
- B3 Pasuritë kapitale ishin mbivlerësuar për 3,220,349€ si rrjedhojë e klasifikimit të pasurive në klasa jo përkatëse në regjistrin kontabël.

Më gjërësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit ‘Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare’. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas konkluzionit tonë, për shkak të rëndësisë së çështjes/ve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit të Komunës së Prishtinës nuk kanë qenë në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

- A2 Janë vërejtur parregullsi në menaxhimin e subvencioneve për kopshtin publiko privat.
- A3 Komuna në tri (3) raste nuk kishte lidhur kontratën në bazë të procedurave adekuate të prokurimit.
- A4 Ne një (1) rast, Komuna kishte hyrë në obligime kontraktuale pa mbulesë të mjaftueshme buxhetore në shumën prej 1,398,964€.
- A5 Në dy (2) raste, lejet e ndërtimit janë lëshuar pas fillimit të procedurave të prokurimit dhe pas nënshkrimit të kontratave.
- A6 Vlera prej 5,200,000€ është paguar në formë të paradhënisës në kundërshtim me Ligjin e prokurimit publik dhe Ligjin e buxhetit.
- A7 Komuna kishte lidhur kontratë të re në vlerë prej 1,200,000€ për shërbime të projektimit pavarësisht ekzistencës së kontratës aktuale për shërbime të ngajshme.
- A8 Në tri (3) raste kemi hasur në dobësi gjatë menaxhimit të kontratave "Në shtëpi".
- B4 Në 31 raste të pagesave në vlerë 4,382,079€ nuk ishin respektuar hapat e përcaktuara për procedim të pagesave, pasi që urdhërblerjet ishin procesuar pas pranimit të faturës dhe në 27 pagesa në vlerë 3,172,852€ zotimet ishin hartuar dhe nënshkruar pas pranimit të faturës.
- B5 Në tri (3) procedura të prokurimit, operatorët ekonomik të përgjedhur si fitues, ishin të papërgjegjshëm.
- B6 Në 17 pagesa të investimeve kapitale, me vlerë totale 3,400,807€ janë bërë ndryshimet në shumat e ndara buxhetore të projekteve kapitale pa aprovim të Kuvendit Komunal.
- B7 Në nëntë (9) kontrata kishte vonesa në realizimin e punimeve.
- B8 Në dhjetë (10) kontrata për punë, ka pasur rritje të sasive në pozicione, pa marrë aprovimet e duhura.
- B9 Në tri (3) kontrata publike kornizë me çmime për njësi, vlera e shpenzuar e një kategorie të caktuar, ka tejkaluar vlerën e lejuar për shpenzim sipas peshimit.
- B10 Në 12 pagesa me vlerë të përgjithshme prej 1,143,191€ kemi vërejtur se faturat ishin vonuar për pagesë, përtëj afatit ligjor prej 30 ditësh.
- B11 Komuna ka ndarë subvencion për një (1) OJQ në fushën e sportit në vlerë prej 50,000€, pa shpallur thirrje publike dhe pa lidhur marrëveshje me përfituesin.

Më gjërisisht shih nënkapitullin 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Çështje tjetër

- 1 Procedurat e prokurimit si: "Ndërtimi i ishullit urban Arbëri - Pallati i Rinisë" me vlerë të kontraktuar prej 6,589,459€ dhe "Ndërtimi i therrtores publike" prej 2,877,777€ nuk i kemi testuar, të cilat sipas dëshmive të siguruara nga Komuna janë në procedurë hetimore nga organet e drejtësisë.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Kryetar i Komunës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryetar i Komunës është përgjegjës edhe për vendosjen e kontolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetar i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës së Prishtinës.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Komunës së Prishtinës është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Komunës së Prishtinës në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërsi nuk përbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërsi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komunës së Prishtinës me kriteret e përcaktuara te auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinion. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulum, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësimë ose anashkalim të kontolleve të brendshme.

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësimë ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komunës së Prishtinës.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuara me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet⁴

Gjatë auditimit, kemi identifikuar fusha në të cilat nevojiten përmirësimë në menaxhimin financiar dhe kontrollin, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve.

Çështjet më me fokus dhe që kanë ndikuar në opinionin financiar të auditimit janë ato që kanë të bëjnë me klasifikimin jo të duhur të shpenzimeve, paraqitjen jo të drejtë dhe jo të saktë të detyrimeve kontingjente, pasurive jofinanciare, dhe llogarive të arkëtueshme.

Kontrolllet mbi të hyrat kanë nevojë të forcohen tek gjenerimi i informacioneve të sakta lidhur me vonesat në shqyrtimin e lejeve ndërtimore dhe mangësitë te shfrytëzimi i pronës publike.

Fusha për përmirësim të mëtejshëm janë identifikuar tek menaxhimi jo i mirëfilltë kontratave publike dhe i subvencioneve, pagesa për punë dhe shërbime pa procedura të prokurimit dhe raporte të pranimit, ndryshimet në shuma buxhetore pa aprovimet e duhura, mangësi në procesin e vlerësimit të ofertave gjatë procedurave të prokurimit dhe aplikimi i drejtë i tyre.

Nga mostrat e testuara, kemi vërejtur se gjatë vitit 2024 janë realizuar shpenzime në vlerë prej 3,511,845€ për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore. Nga kjo shumë, 2,437,372€ janë paguar për borxin kryesor, ndërsa 1,074,473€ janë shpenzuar për kamata dhe shpenzime përmbarimore.

Ndërsa, tek fusha e pasurisë, masa të mëtejme duhet të ndërmerren për funksionalizimin e e-pasurisë dhe kryerjen e procesit të inventarizimit sipas kërkesave të rregullores për pasuritë.

Gjetjet dhe rekomandimet kanë për qëllim të bëjnë korrigimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrolllet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondevë të sektorit publik. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Ky raport ka rezultuar me 27 rekomandime, prej tyre 12 janë rekomandime të reja, 14 rekomandime të përsëritura dhe një (1) rekomandim pjesërisht i përsëritur. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

Çështja A1 - Prezantim jo i drejtë llogarive të arkëtueshme në PVF

Gjetja Sipas nenit 16 të Rregullores MF-nr.01/2017 për raportim vjetor financiar për organizata buxhetore, është përcaktuar që OB-të që mbledhin të hyra, janë të detyruara të mbajnë regjistra të plotë për shumat e paarkëtuara.

Gjatë testimit të llogarive të arkëtueshme, kemi vërejtur prezantim të pasaktë të të dhënave në PVF:

- Në një (1) rast tek taksa për mbledhjen e mbeturinave, pagesa në vlerë prej 8,052€ ishte përfshirë gabimisht si zbritje në listën e

- Ilogarive të arkëtueshme. Në të njëjtën kohë, kjo shumë ishte regjistruar edhe në analitikën e klientit, duke rezultuar në nënverësim të vlerës së përgjithshme të të arkëtueshmeve për të njëjtën shumë; dhe
- Në anën tjetër, nga taksat për infrastrukturë, Ilogaritë e arkëtueshme ishin mbivlerësuar në vlerë prej 38,061€.

Këto pasaktësi kanë ndodhur si rezultat i mungesës së kontrolleve të brendshme efektive dhe mospërputhjes ndërmjet evidencave të brendshme dhe të dhënavë të raportuara në pasqyrat financiare.

Ndikimi Prezantimi jo i saktë i Ilogarive të arkëtueshme ndikon në besueshmërinë e informatave financiare, duke çuar në nënverësim ose mbivlerësim të tyre në PVF.

Rekomandimi A1 Kryetari duhet të sigurojë forcimin e kontrolleve të brendshme, me qëllim të përmirësimin të procesit të menaxhimit dhe raportimit të saktë të Ilogarive të arkëtueshme në PVF.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B1 - Mbivlerësimi dhe mos raportimi i detyrimeve kontingjente në pasqyrat vjetore financiare (PVF)

Gjetja Sipas nenit 18 të Rregullores nr.01/2017 për Raportim Vjetor Financiar, organizatat buxhetore në harmoni me LMFPP-në, raportojnë të gjitha detyrimet kontingjente.

Gjatë auditimit të detyrimeve kontingjente, kemi vërejtur se vlera e raportuar në PVF ishte mbivlerësuar në vlerë prej 3,886,576€, konkretisht ishte mbivlerësuar në vlerë prej 4,185,823€, ndërsa në anën tjetër ishte nënverësuar në shumën prej 299,247€, për shkak të rasteve si në vijim:

- Në dy (2) raste, në vlerë prej 3,548,368€, paditë ishin tërhequr nga paditësit, dhe përmes aktvendimeve të Gjykatës Themelore, është konstatuar se nuk ka mundësi ankesë. Megjithatë, ato ishin ende të prezantuara në PVF si padi aktive;
- Një (1) rast, në vlerë prej 268,625€, i cili ishte shlyer përmes përbabarimit gjatë vitit 2024, ishte sërisht i raportuar si detyrim kontingjent në PVF;
- Një (1) rast, në vlerë prej 333,333€, ishte prezantuar si detyrim kontingjent, ndonëse Tribunali i Përherershëm i Arbitrazhit kishte shpallur mungesë juridiksioni për ta shqyrta rastin dhe pala ishte udhëzuar ta ndjekë çështjen në gjykatë. Paditësi nuk kishte ndërmarrë ndonjë veprim pasues gjyqësor;
- Një (1) padi, në vlerë prej 35,497€, ishte prezantuar dy herë në PVF, duke rezultuar në dyfishim të shumës për të njëjtin rast;
- Dy (2) padi në vlerë totale prej 4,065,587€, të cilat ishin përfshirë në PVF, por me vlerë të nënverësuar për 299,247€, në krahasim me dokumentacionin ligjor të disponueshëm; dhe
- Gjithsej 327 padi aktive, që lidhen me kontratën kolektive dhe për të cilat ende nuk ishte përcaktuar një shumë e saktë e pretenduar, nuk ishin përfshirë fare në PVF si detyrim kontingjente, edhe pse ekziston një mundësi reale që ato të rezultojnë në dëmshpërblime për institucionin. Zyra ligjore kishte dërguar listën e këtyre rasteve, mirëpo zyra e financave nuk i kishte përfshirë ato në raportim, duke

vepruar me mendimin se paditë pa vlerë të saktësuar nuk duhen përfshirë në pasqyrat financiare. Kjo përfaqëson një mangësi në interpretimin e kërkesave të raportimit sipas rregullores në fuqi dhe praktikave të mira kontabël.

Kjo situatë ka ndodhur për shkak të mungesës së një sistemi të mirëfilltë për menaxhimin e lëndëve, të cilat aktualisht mbahen në formë fizike, gjë që ka ndikuar në kontroll të dobët të brendshëm për përditësimin dhe menaxhimin e tyre. Mos përfshirja e lëndëve aktive pa vlerë të precizuar në PVF ka ndodhur për shkak të mos koordinimit të duhur dhe qartësimit ndërmjet zyrës ligjore dhe zyrës së financave.

Ndikimi	Prezantimi i detyrimeve kontingjente në vlera jo të sakta ndikon që palët e interesit apo shfrytëzuesit e PVF të mos informohen drejtë dhe saktë lidhur me shpalosjen e këtyre detyrimeve, njëherësh ndikon në planifikim jo të mirë të buxhetit për vitin vijues.
----------------	--

Rekomandimi B1	Kryetari duhet të ndërmarrë masa për të zhvilluar një sistem të brendshëm të kontrollit për menaxhimin e detyrimeve kontingjente, përfshirë krijimin e një sistemi të mirëfilltë për lëndët gjyqësore dhe paditë në proces. Po ashtu, rekomandohet që zyra e financave dhe ajo ligjore të bashkëpunojnë ngushtë, me qëllim që çdo detyrim potencial të identifikohet, të vlerësohet në mënyrë të rregullt dhe të përfshihet në pasqyrat financiare me dokumentacion mbështetës adekuat.
-----------------------	---

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B2 - Keqklasifikimi i shpenzimeve në kategoritë ekonomike

Gjetja	Sipas nenit 18 pikës 3 të Rregullës Financiare Nr. 01/2013 Shpenzimi i parave publike, shpenzimet duhet të kenë kodet adekuate, të përcaktuara me planin kontabël. Po ashtu me planin kontabël të Thesarit janë përcaktuar kodet dhe kategoritë përkatëse të shpenzimeve që OB-të duhet të aplikojnë.
---------------	---

Në bazë të pagesave të testuara, kemi vërejtur se janë bërë pagesa nga kodet joadekuante, në vlerë 3,907,548€ si në vijim:

- Nga kategoria e investimeve kapitale, janë bërë pagesa që i takojnë mallrave dhe shërbimeve në gjashtë (6) raste në vlerë prej 1,019,281€, ndërsa që i takojnë pagesa në vlerë prej 760,760€ që i takojnë subvencioneve dhe transfereve;
- Nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve, janë bërë pagesa që i takojnë pagave dhe mëditjeve në dy raste me vlerë 5,400€; pagesa që i takojnë subvencioneve dhe transfereve në pesë (5) raste në vlerë 81,006€, si dhe investimeve kapitale një rast në vlerë 150,017€; si dhe
- Nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve, janë bërë pagesa që i takojnë mallrave dhe shërbimeve, në dhjetë (10) raste në vlerë 382,921€.

Me rastin e ekzekutimit të pagesave nga thesari për obligimet e kontratës kolektive, nga 12 mostrat e testuara në vlerë prej 3,511,846€ në shtatë (7) raste kemi vërejtur keqklasifikime të shpenzimeve nëpër kategori ekonomike në vlerë 1,508,162€. Nga kjo vlerë, nga mostrat e testuara thesari kishte paguar sipas vendimit përmbarimor të gjykatës për paga

jubilare dhe shujta për arsimtarë nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve 224,709€ dhe nga kategoria e investimeve kapitale 1,283,453€.

Klasifikimi joadekuat i shpenzimeve ishte rezultat i mosfunkcionimit të mirë të kontolleve të brendshme në planifikimin e buxhetit dhe realizimin e pagesave nga kategoritë adekuate. Ndërsa, keqklasifikimet me rastin e vendimeve gjyqësore kanë ndodhur për shkak të mungesës së ndarjeve buxhetore në kategorinë ekonomike adekuate për t'i realizuar pagesat e vendimeve gjyqësore përmbarimore si dhe buxhetimit dhe planifikimit jo të mirë buxhetor.

Ndikimi	Pagesat e kryera nga kategoritë joadekuate të shpenzimeve ndikojnë në raportimin financiar jo të drejtë, si dhe në mbivlerësimin/nënvlërësimin e kategorive të shpenzimeve.
Rekomandimi B2	Kryetari duhet të sigurojë se shpenzimet planifikohen dhe realizohen sipas kategorive ekonomike adekuate, në përputhje me planin kontabël, për të mundësuar raportimin e drejtë të tyre në PVF.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B3 - Mbivlerësim i regjistrat të pasurisë dhe pasaktësi në regjistrimin e informatave në regjistrat kontabël të pasurisë

Gjetja	Neni 11 paragrafi 1 dhe 3 i Rregullores MF nr. 02/2013 Për Menaxhimin e Pasurisë jo Financiare në Organizatat Buxhetore përcakton se "Pasuritë jo financiare kapitale që gjenden në fazën e investimeve në vijim apo në fazën e ndërtimit duhet të regjistrohen në regjistrin kontabël në kategorinë e investimeve në vijim", "Pas përfundimit të procesit të investimit pasuria jo financiare kapitale do të klasifikohet si pasuri jo financiare në përdorim. Nga momenti i aftësimit të pasurisë për përdorim do të zbatohet edhe zhvlerësimi".
	Ndërsa, sipas nenit 8 pika 4 theksion se Zyrtari Kryesor Administrativ me vendim formon Komisionin për Pranimin e Pasurisë jo Financiare që ka përgjegjësitë të bëjë verifikimin e sasisë, cilësisë, llojin dhe vlerën e pasurisë jo financiare të pranuar dhe të dokumentuar me procesverbal që janë në përputhmëri me kontratën apo urdhërblerjen.

Gjatë auditimit kemi identifikuar pasaktësi në regjistrimin dhe përditësimin e informatave në regjistrin kontabël të pasurisë për rastin si në vijim:

- Një transfer i bërë në vlerë prej 5,120,000€ në kuadër të marrëveshjes në mes Komunës së Prishtinës dhe UNDP për modernizimin e arsimit përmes inovacionit dhe trashëgimisë kulturore, është regjistruar në regjistrat e pasurisë si pasuri në përdorim - objekte kulturore. Ky projekt ende nuk është përfunduar dhe pasuritë përkatëse nuk janë pranuar nga komuna. Si rrjedhojë, regjistrimi i këtyre mjeteve si pasuri në përdorim nuk është në përputhje me kërkuesat për regjistrimin e pasurive kapitale.

Gjatë testimit të pasurive kapitale, kemi vërejtur se vlera e raportuar në PVF ishte mbivlerësuar për 3,220,349€ për rastet si në vijim:

- Gjithsej 44 pasuri, në vlerë 2,486,110€, që i përkasin 11 projekteve kapitale të përfunduara nga vitet 2016-2018, janë të regjistruara si

- investime në vijim edhe pse duhej të ishin klasifikuar si pasuri në përdorim dhe të aplikohet zhvlerësimi në vlerë neto prej 745,234€. Në këtë rast pasuritë janë mbivlerësuar për 745,234€;
- Një (1) projekt me vlerë 2,000,000€, që lidhet me aktivitetin e matjes së ngrohjes qendrore, në kuadër të projektit përfunduar në vjetin 2021 ndërmjet Komunës dhe Fondacionit të Mijëvjeçarit të Kosovës (MFK), me qëllim mbështetjen e shërbimit të matjes së ngrohjes për klientët e lidhur me rrjetin Termokos dhe ka përfunduar në vitin 2022.
Sipas kushteve të kësaj marrëveshjeje, asetat e blera në kuadër të projektit mbeten në dispozicion të Ndërmarrjes Termokos, dhe si rrjedhojë, nuk duhet të figurojnë në regjistrat e SIMFK-së si pasuri komunale. Në ketë rast pasuritë janë mbivlerësuar për 2,000,000€;
 - Dy (2) situacione të regjistruara si investime në vijim në vlerë prej 200,000€ kishin mbetur të evidentuara në këtë kategori, ndonëse projektet përkatëse ishin përfunduar në vitin 2016 dhe vlera e tyre ishte përfshirë tashmë në regjistrin e pasurive në përdorim me vlerë totale neto prej 496,194€. Si të tilla duhet të fshihen. Në këtë rast pasuritë janë mbivlerësuar për 200,000€;
 - Po ashtu, dy (2) situacione për një projekt kapital të regjistruara në vitin 2024, me vlerë 180,704€, si investime në vijim, kanë mbetur në këtë kategori përkundër faktit që ishin regjistruar si pasuri në përdorim në vlerë prej 512,434€. Në ketë rast pasuritë janë mbivlerësuar për 180,704€.
Për këtë të fundit zyrtari i pasurisë iu kishte drejtuar Thesarit për shlyerjen e tyre, mirëpo kërkesa nuk ishte shumë e qartë dhe si pasojë këto situacione janë të regjistruara dy herë, duke shkaktuar pasqyrim të dyfishtë të tyre në regjistrat e pasurisë; dhe
 - Tre (3) situacione në vlerë 94,411€, të regjistruara si investime në vijim në vitin 2018, në fakt janë pagesa të keqklasifikuara dhe nuk përbëjnë pasuri kapitale. Në ketë rast pasuritë janë mbivlerësuar për 94,411€.

Mangësitë e identifikuara kishin ardhur si rezultat i mos funksionimit të kontrolleve të brendshme në procesin e menaxhimit të pasurive dhe ngarkesës së madhe të punës mbi vetëm një zyrtar të pasurisë.

Ndikimi	Mangësitë e lartë cekura ndikojnë në mosparaqitjen e drejtë të gjendjes së pasurisë në pasqyrat financiare dhe rrezikon keq menaxhimin e saj.
Rekomandimi B3	Kryetari duhet të sigurojë që të ndërmerren masa konkrete për përmirësimin e menaxhimit të pasurisë komunale, duke garantuar që regjistrimi, klasifikimi dhe përditësimi i të gjitha pasurive të bëhet në përputhje me gjendjen reale dhe kërkesat ligjore. Po ashtu, duhet të shqyrtohet nevoja përritjen e kapaciteteve njerëzore në këtë fushë, me qëllim të menaxhimit më efikas dhe më të saktë të pasurive.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja A2 - Parregullsi në procesin e menaxhimit të subvencioneve për kopshtin publiko privat

Gjetja

Më datën 23.11.2018, Kryetari i Komunës ka miratuar vendimin për subvencionimin e prindërve që regjistrojnë fëmijët e tyre në çerdhe me bazë në komunitet në Komunën e Prishtinës. Sipas këtij vendimi, subvencioni ndahet në bazë të të ardhurave mujore të prindërve. Pika 5 e vendimit përcakton se vlerësimi i kërkesave dhe vendimmarrja për përfitimin e subvencionit duhet të bëhet nga një përfaqësues i Komunës dhe dy përfaqësues të çerdhes. Për zbatimin e vendimit janë përgjegjëse Drejtoria e Arsimit dhe Drejtoria e Financave.

Sipas nenit 35 paragrafi 7 të Rregullores së brendshme të Kopshtit, prindërit të cilët kanë të ardhura më pak se 1,000€ do të subvencionohen nga Komuna e Prishtinës si në vijim: prindërit të cilët kanë të ardhura deri 500€, Komuna do t'i subvencionoj me 50€ për fëmijë; prindërit të cilët kanë të ardhura deri në 700€, Komuna do t'i subvencionoj me 30€ për fëmijë, prindërit të cilët kanë të ardhura deri në 800€, Komuna do t'i subvencionoj me 20€ për fëmijë dhe prindërit të cilët kanë të ardhura deri mbi 1,000€ në muaj dhe ata të cilët udhëheqin biznes individual nuk përfitojnë subvencion nga Komuna.

Ndërsa, neni 5 thekson se Komisioni për verifikimin e dokumentacionit përbëhet nga Administratorja, Kryesuesja e Këshillit të Kopshtit dhe Përfaqësuesi nga Komuna. Neni 8 përcakton se Drejtoresha ekzekutive e kopshtit vendos përfundimisht për përfitimin e subvencioneve.

Gjatë vitit 2024, Komuna e Prishtinës ka paguar 58,820€ në formë të subvencionimit për kopshtin publiko-privat Botanika. Në këtë proces gjatë auditimit janë identifikuar disa parregullsi që lidhen me mos zbatimin e kërkesave ligjore dhe mungesën e kontrollit nga Drejtoritë përgjegjëse si në vijim:

- Komisioni për verifikimin dhe vlerësimin e dokumentacionit gjatë vitit 2024 nuk ka qenë funksional. Përfaqësuesi i Komunës nuk ka marrë pjesë në procesin e shqyrtimit të dokumentacionit dhe miratimit të listave;
- Listat e përgatitura nga kopshti, të cilat janë dorëzuar në Komunë për pagesë, ishin nënshkruar vetëm nga administratorja e kopshtit, pa përfshirjen e komisionit të plotë dhe pa nënshkrimin e përfaqësuesit të Komunës, ashtu siç kërkohet në vendimin e Kryetarit të Komunës;
- Listat ishin manipuluar duke raportuar të ardhurat e pasakta të prindërve që përfitojnë subvencion për fëmiun e tyre përmes përfshirjes në lista fëmijë përfitues që nuk i plotësonin kriteret për subvencionim; dhe
- U vërejtën tërheqje përmes bankomatit në vlerë prej 46,320€.

Lidhur me këtë, nga 14 mostrat e testuara kemi vërejtur se:

- Shtatë (7) prindër kishin paguar tarifën e plotë mujore, pavarësisht faktit që kopshti kishte përfituar subvencione në emër të tyre në vlerë të përgjithshme prej 3,900€; dhe

- Katër (4) fëmijë që nuk kanë ndjekur kopshtin gjatë vitit 2024 ishin përfshirë në lista dhe kopshti kishte përfituar subvencione për ta në vlerë totale prej 3,150€.

Për qëllime të pagesës së subvencioneve, kopshti kishte ofruar në Komunë gjendjen e llogarisë bankare si dëshmi për verifikimin e pagesave mujore të prindërve për fëmijët e subvencionuar. Mirëpo, kjo dëshmi ishte falsifikuar pasi që të dhënat e prezantuara në llogarinë bankare të dorëzuar nuk përputheshin me të dhënat reale të pagesave mujore nga prindërit. Për shembull, prindi kishte paguar tarifën e plotë mujore prej 150€, ndërsa në gjendjen e llogarisë bankare të prezantuar në Komunë kjo pagesë ishte paraqitur si 50€, me qëllim që të arsyetohej përfitimi i subvencionit.

Kjo situatë ka ardhur si rezultat i mangësive në menaxhimin dhe kontrollin nga ana e Komunës, si dhe mosrespektimit të procedurave të përcaktuara në vendimin e Kryetarit të Komunës. Për më tepër, është evidentuar mungesë e përgjegjësisë institucionale nga ana e zyrtarëve kompetentë të Komunës dhe përfaqësuesve të kopshtit, të cilët nuk kanë ndërmarrë veprimet e nevojshme për të siguruar që procesi i subvencionimit të zhvillohet në mënyrë të rregullt, të drejtë dhe në përputhje me kërkesat liqore.

Ndikimi	Mungesa e mbikëqyrjes së subvencioneve ka ndikuar në keqpërdorimin e fondeve publike dhe mundësinë për përfitime të padrejta. Kjo situatë cenon besueshmërinë dhe qëllimin e subvencionimit publik.
Rekomandimi A2	Kryetari i Komunës duhet të sigurojë që Drejtoria e Arsimit dhe ajo e Financave të vodosin mekanizma funksionalë të kontrollit për procesin e subvencionimit, duke garantuar përfshirjen dhe funksionimin e komisionit për verifikimin dhe vlerësimin e dokumentacionit në përputhje me vendimin e miratuar. Po ashtu, duhet të zhvillohet një rishikim i plotë i subvencioneve të dhëna gjatë vitit 2024 për të identifikuar dhe adresuar përfitimet e pajustifikuara. Në rastet kur konstatohet përfitim në kundërshtim me kriteret, të merren masa ligjore dhe administrative për kthimin e fondeve publike dhe përgjegjësinë e zyrtarëve të përfshirë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A3 - Aplikim i procedurave të prokurimit me negocim jo në përputhje me Ligjin për prokurim publik (LPP)

Gjetja

Sipas neni 35 të LPP, Autoriteti kontraktues mund të përdorë procedurat e negociuara pa publikimin e njofitimit të kontratës për të ushtruar aktivitetin e prokurimit vetëm pasi që të jetë në pajtim me këtë nen, pika 2.1 (iii) nëse, për aq sa është shumë e nevojshme për arsyet e emergjencave ekstreme që janë shkaktuar nga ngjarje objektivisht të verifikueshme të cilat nuk kanë pasur mundësi të parashikohen me arsyet nga autoriteti përkatës kontraktues, autoriteti i tillë kontraktues nuk mund ta japë kohën e kërkuar për ushtrimin e cilësdo procedurë tjetër që parashtohet në këtë ligj. Me kusht që kjo dispozitë të mos mund të shfrytëzohet nëse rrethanat që e kanë krijuar situatën emergjente ekstreme mund t'u atribuohen veprimeve neglighente ose të qëllimita ose lëshimeve të autoritetit kontraktues.

Ndërsa, sipas nenit 9.4 përcaktohet se nëse autoriteti kontraktues është autoritet publik, autoriteti i tillë publik duhet të marrë masa të arsyeshme për t'u siguruar se lëndët që i përbushin këto nevoja nuk janë në dispozicion nga ndonjë autoritet tjetër publik.

Komuna ka përdorur procedurën e negociuar pa publikim të njofitimit të kontratës në tri raste, ndonëse kushtet ligjore për përdorimin e saj nuk ishin të plotësuara:

- Komuna ka zhvilluar procedurë të negociuar pa publikim të njofitimit për kontratën "Ofrimi i makinerisë shtesë për shërbimin e grumbullimit, transportimit dhe deponimit të mbeturinave komunale" në vlerë prej 1,000,000€, ndonëse nuk ishin plotësuar kushtet ligjore për përdorimin e kësaj procedure. Kjo ishte bërë përmes angazhimit të një operatori privat me afat njëvjeçar, ndonëse Komuna kishte një kontratë aktive "Në shtëpi" me KRM Pastrimin për shërbimet e tillë lidhur më 29.02.2024, ku Komuna e Prishtinës është aksionare kryesore. Përdorimi i kësaj procedure është arsyetuar nga Komuna në bazë të vendimit për shpalljen e gjendjes emergjente të datës 14.02.2024, i cili pasonte nga një raport i përgatitur nga grupi punues i themeluar më 08.11.2023 dhe i cili përshkruan gjendjen e evidentuar nga kjo datë. Ky raport evidentonte parregullsi në menaxhimin e mbeturinave dhe u përdor si bazë për të justifikuar situatën emergjente.

Komuna kishte kohë që ishte në dijeni për problemet me operatorin ekzistues KRM "Pastrimi", përmes ankesave të qytetarëve dhe vërejtjeve të përsëritura për moszbatim të detyrimeve sipas kontratës. Kjo situatë tregon se nevoja për angazhim shtesë të makinerisë nuk ishte e paparashikueshme". Ky aktivitet ishte paraparë gjithashtu në planin e prokurimit të vitit 2024. KRPP gjatë monitorimit ka dhënë opinion për rishqyrtimin e mundësisë së shmangies së përdorimit të kësaj procedure me qëllim të rritjes së transparencës dhe konkurrencës. Nga déshmitë e analizuara shohim se Komuna nuk i ka shtjerrë të gjitha mundësitë për të zgjidhur situatën përmes bashkëpunimit me KRM "Pastrimi". Për më tepër, nuk është dokumentuar ndonjë analizë për identifikimin e alternativave për përmirësimin e zbatimit të kontratës ekzistuese ose angazhimin e ndonjë operatori tjetër publik para se të angazhohej operatori privat.

Në përgjigjen zyrtare të dhënë nga KRM “Pastrimi” gjatë procesit të auditimit, është dekluaruar se atyre nuk u është ofruar ndonjë mundësi për të paraqitur propozim zyrtar apo për të qenë pjesë e një procesi formal të konkurrencës. Sipas Ndërmarrjes, kontrata është inicuar dhe lidhur në mënyrë të drejtpërdrejtë nga Komuna, pa ndonjë njoftim paraprak.

- Komuna kishte lidhur kontratën “Ndërtimi i strehimores për qentë endacak - Negociuar”, në vlerë prej 410,000€, përmes procedurës së negociuar pa publikim të njoftimit të kontratës. Si arsy për përdorimin e kësaj procedure ishte paraqitur një situatë emergjente lidhur me rrezikun që paraqesin qentë endacakë për qytetarët. Megjithatë, nga auditimi është konstatuar se kjo kontratë ishte lidhur si pasojë e një kontrate paraprake në vlerë prej 187,115€, e cila parashihet ndërtimin e strehimores në Slivovë, në një sipërfaqe prej 8 hektar. Më pas, Komuna kishte vendosur zhvendosjen e projektit në një lokacion tjetër në Hajvali, në një hapësirë më të vogël prej 3.5 hektar, të konsideruar më të përshtatshëm. Pozicionet në paramasën e kontratës së parë tregojnë se projekt i nuk ishte i plotë, sepse nuk përfshinte disa pozicione bazike si p.sh (ndërtimin e objekteve për qenë). Si rezultat i ndryshimit të lokacionit dhe plotësimit të disa pozicioneve u kontraktuan punë shtesë që nuk ishin përfshirë në kontratën fillestare, për të cilat Komuna ka lidhur një kontratë të dytë përmes procedurës së negociuar.

Sipas nenit 35 të LPP-së, pika 2.4 të Ligjit për Prokurimin Publik, procedura e negociuar pa publikim mund të përdoret vetëm për zbatimin ose ekzekutimin e punëve shtesë, që nuk ishin përfshirë as në konceptin fillesttar të një projekti të dhënë më parë, por të cilat për shkak të rrethanave të paparashikuara janë bërë të nevojshme, por me kusht që shuma për punë shtesë që vetëm ose së bashku nuk kanë një vlerë më të madhe se 10% e kontratës fillestare.

Në këtë rast, kontrata e dytë kap vlerën prej 410,000€, që përbën një tejkalim prej 119.1% në raport me kontratën fillestare - përtej kufirit të lejuar me ligji. Për më tepër, ky projekt ishte i përfshirë në planin e prokurimit në vlerë prej 450,000€, që tregon se nuk ishte situatë e paparashikueshme. Kjo tregon se përdorimi i procedurës së negociuar në këtë rast nuk ishte i arsyeshëm dhe në kundërshtim me kërkuesat ligjore për prokurim publik. Komuna është dashur të aplikojë një procedurë të hapur të prokurimit, duke respektuar parimet e konkurrencës dhe transparencës.

- Komuna kishte lidhur kontratën “Renovimi i institucioneve edukativosimore - Byfetë” në vlerë prej 849,306€, përmes procedurës së negociuar pa publikim të njoftimit të kontratës. Si arsyetim për përdorimin e kësaj procedure është përdorur vendimi i Kryetarit të Komunës, i datës 29.07.2024, për miratimin e programit të mësimit tërëditor në pesë shkolla të Prishtinës. Ky arsyetim është përmendur gjithashtu në njoftimin për kontratë në KRPP, ndërkaq nuk ka qenë e paraparë në plan të prokurimit. Megjithatë, nga auditimi kemi konstatuar se nevoja për renovimin e byfeve nuk përbën një rrethanë të paparashikueshme apo të jashtëzakonshme, siç kerkohet me legjislacionin për prokurim publik për të justifikuar përdorimin e procedurës së negociuar pa publikim. Vendimi për aplikimin e

mësimit tërëditor nuk ka qenë si ngjarje që rrjedh nga emergjencat ekstreme që janë shkaktuar nga ngjarjet objektivisht të verifikueshme të cilat nuk kanë patur mundësi të parashikohen. Si rrjedhojë, përdorimi i procedurës së negociuar në këtë rast bie ndesh me kërkuesat ligjore për këtë lloj procedure. Komuna është dashur të aplikojë një procedurë të hapur, duke siguruar konkurrencë dhe transparencë në prokurim.

Lëshimet në planifikim, mos adresimi i situatave në kohë dhe mungesa e veprimeve të koordinuara nga ana e Komunës kanë çuar në përdorimin e padrejtë të procedurës së negociuar pa publikim, duke anashkaluar procedurat konkuruese të parashikuara me ligj.

Ndikimi

Përdorimi i procedurës së negociuar pa publikim cenon konkurrencën dhe transparencën në prokurim publik, duke krijuar rrezik për favorizim, menaxhim joadekuat të fondeve publike, si dhe zvogëlim të besimit të publikut në sistemin e prokurimit. Mos kontraktimi i shërbimeve të cilat ofrohen nga autoritetet publike ndikon që Komuna të kontraktoj këto shërbime me një çmim më të lartë.

Rekomandimi A3

Kryetari duhet të sigurojë që procedura e negociuar pa publikim të përdoret vetëm në raste të jashtëzakonshme dhe në përputhje të plotë me kushtet të përcaktuara në kërkuesat ligjore. Para se të angazhojë operatorë privat, duhet të shqyrtohen kapacitetet me autoritetet publike, dhe të dokumentohen përpjekjet për bashkëpunim me to.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A4 - Hyrja në obligime kontraktuale pa fonde të mjaftueshme

Gjetja

Neni 12, paragrafi 7 i Ligji nr. 08/L-260 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës, për vitin 2024, limitet në zotime dhe shpenzime, Nënshkrimi i kontratave për projekte kapitale shumëvjeçare bëhet nga OB-të vetëm në raste se shpenzime e tillë për kosto totale të projektit janë të parapara në ligjin e buxhetit për vitin fiskal 2024 dhe për dy (2) vitet në vijim, tabela 4.2 Financimi i Investimeve Kapitale Komunale, planifikohen financimin e projekteve dhe shumën e ndarë që duhet të realizohen brenda tri viteve.

Gjatë auditimit kemi vërejtur se Komuna kishte lidhur kontratë për projektin “Ndërtimi i Qendrës për Punë Sociale” me vlerë 2,898,964€, me afat për përfundimin e punimeve prej 240 ditë kalendarike. Sipas Ligjit të Buxhetit, Komuna kishte të ndara mjete buxhetore për këtë projekt për periudhën 2024-2026, në vlerë totale prej 1,500,000€, që nënkupton se ka hyrë në obligime kontraktuale pa mbulesë të mjaftueshme buxhetore, në shumën prej 1,398,964€.

Gjithashtu, është vërejtur mospërputhje në dokumentet planifikuese të projektit në Deklaratën e nevojave dhe disponueshmërisë së fondeve sepse ishte parashikuar vlera prej 2,916,477€ e cila tejkalon vlerën e buxhetuar të projektit, ndërsa në planin e prokurimit për vitin 2024 ky projekt ishte planifikuar të realizohej vetëm në shumë prej 500,000€.

Kjo ka ndodhur për shkak të mosfunkcionimit të kontrolleve me rastin e iniciimit të procedurave të prokurimit, si dhe mungesës se planifikimit të

mirëfilltë buxhetore për projekte të caktuara.

Ndikimi	Hyrja në obligime financiare pa siguar fondet e nevojshme, ndikon në rritjen e obligimeve të papagueshme financiare dhe shpenzimeve të përmbarimit dhe anashkalim të ligjit të buxhetit apo implikime buxhetore për vitin aktual dhe vijues.
Rekomandimi A4	Kryetari duhet të sigurojë se të gjitha kontrolllet e nevojshme funksionojnë gjatë tërë kohës, në mënyrë që para iniciimit të procedurave të prokurimit të sigurohet se projektet kapitale janë të përfshira në ligjin e ndarjeve buxhetore ka fonde të mjartueshme buxhetore të ndara me ligjin për ndarjet buxhetore për të gjitha kontrata e lidhura.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A5 - Fillimi i procedurave të prokurimit pa lëshimin e lejeve ndërtimore

Gjetja	Sipas neni 5 paragrafi 1.1 i Ligjit të ndërtimit, thekson se llojet e ndërtimit janë ndërtimi i ri (përfshirë edhe instalimin), rindërtimi, riparimi - renovimi, sanimi, rehabilitimi-përmirësimi (nuk kërkon leje ndërtimi), punët ndërtimore që kanë për synim mbrojtjen e monumenteve të palëvizshme të trashëgimisë kulturore, rrënimini, ndërtime peizazhi dhe instalimi apo ngritja e ndërtimeve te përkohshme.
	Neni 19 i këtij ligji thekson se Komunat lëshojnë leje ndërtimore për kategoritë I dhe II të ndërtimeve.

Nëse organi kompetent vlerëson se dokumentacioni ndërtimor nuk është përgatitur në përputhje me kushtet ndërtimore dhe me dispozitat e këtij ligji, Kodit si dhe Ligjit mbi mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, duke përfshirë edhe zonat e veçanta të mbrojtura, nuk do të lëshojë lejen ndërtimore.

Gjatë auditimit janë evidentuar dy raste ku lejet për zhvillimin e punimeve janë lëshuar pas nënshkrimit të kontratave. Ato raste janë:

- Në rastin e ndërtimit të Qendrës për Punë Sociale, me vlerë të kontratës prej 2,898,964€, leja ndërtimore është lëshuar më 20.02.2025, ndërkohë që kontrata për realizimin e projektit ishte nënshkuar më 26.11.2024. Edhe pse në këtë rast punimet nuk kishin filluar pa lejen ndërtimore, procedura është zhvilluar në kundërshtim me rendin ligjor, pasi leja është një dokument parakusht për nënshkrimin e kontratës; dhe
- Në projektin për ndërtimin e rrugës në lagjen Kodra e Trimave, me vlerë kontrate prej 598,764€, është vërejtur se punimet kishin filluar më 22.07.2024, ndërsa vendimi për dhënien e pëlqimit nga Drejtoria e Urbanizmit është lëshuar më 01.08.2024, pra pas fillimit të punimeve dhe pas nënshkrimit të kontratës më 03.07.2024.

Është e rëndësishme të theksohet se në të dy rastet, kërkesat për leje ndërtimore nga Drejtoria e Investimeve Kapitale dhe Menaxhimi i Kontratave janë dorëzuar pas fillimit të procedurave të prokurimit (njoftimeve për kontratë), gjë që tregon për mungesë të planifikimit dhe respektimit të rrjedhës së duhur procedurale.

Këto situata kanë ndodhur si rezultat i mangësive në planifikimin e projekteve dhe mungesës së mekanizmave efektivë të kontrollit të brendshëm, për të siguruar se dokumentacioni i nevojshëm është përgatitur dhe verifikuar përparrë nisjes së procedurave të prokurimit dhe lidhjes së kontratave.

Ndikimi

Mangësitë e lartë përmendura rrezikojnë ligjshmërinë dhe qëndrueshmërinë e ndërtimeve të projekteve kapitale, shtojnë mundësinë e shpenzimeve përmes aneks-kontratave ose ndryshimeve teknike gjatë realizimit, rrezikojnë vonesat në realizimin e projekteve dhe krijojnë mundësi për anulimin apo përsëritje të procedurave për shkak të mungesës së dokumentacionit ligjor të kërkuar.

Rekomandimi A5

Komuna duhet të sigurojë që asnjë procedurë prokurimi për projekte ndërtimi të mos fillojë pa u pajisur më parë me lejen ndërtimore, në përputhje me kërkesat e Ligjit për Ndërtim. Po ashtu, duhet të forcohen mekanizmat e kontrollit të brendshëm dhe të vendosen kërkesa të qarta të bashkëpunimit ndërmjet drejtoreve përkatëse në mënyrë që lejet për fillimin e punimeve të jepen para inicimit të procedurave të prokurimit dhe nënshkrimit të kontratave.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A6 - Kontraktimi dhe pagesat në formë të paradhënies në kundërshtim me Ligjin e prokurimit dhe Ligjin e buxhetit

Gjetja

Sipas nenit 3 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, Autoriteti kontraktues mund të përjashtohet nga zbatimi i procedurave dhe dispozitave të ligjit vetëm nëse: zbatimi i tyre do të komprometonte një sekret të ligjshëm ose interesin e sigurisë, dhe nëse Qeveria ka dhënë pëlqimin që kontrata të përjashtohet nga fushëveprimi i ligjit për shkak të kërkesës përmes masa të veçanta të sigurisë ose klasifikimit të lëndës si sekret shtetëror. Ky përjashtim do të vlejë vetëm në përputhje me Ligjin për qasje në dokumentet publike dhe nuk zbatohet përfundimisht: trajnime pasuniversitare apo profesionale përmes punëtorët, shërbime të përfaqësimit përmes ushqimit e pije, kontratat përmes koncesione që rregullohen me Ligjin përmes PPP, dhe blerjen apo marrjen me qira të pronave të paluajtshme, përvèç rasteve të parashikuara ndryshe me ligj.

Me nenit 13 të Ligjit të Buxhetit nr. 08/L-260 përmes vitit 2024, parashihet se OB-të mund të iu paguajnë paradhënie kontraktuesve përmes projektet kapitale dhe përmes mallra dhe shërbimeve deri në pesëmbëdhjetë përqind (15%) të vlerës është kontratës. Pagesa e tillë mund të bëhet vetëm në bazë të kontratës së lidhur në mënyrë ligjore, me vlerë më të lartë se dhjetëmijë euro (10,000 €) e cila është arritur në përputhje me Ligjin e Prokurimit Publik.

Sipas nenit 21 pika 2 të Rregullës financiare nr. 01/2013 - shpenzimi i parasë publike, Shpenzimet që nuk kërkojnë prokurim janë: pagat, shpenzimet e paguara me para e imët; avancat përmes udhëtimeve; komunalit; subvencionet dhe transferet dhe transaksionet ndërdepartamentale. Ndërkohë Neni 23, pika 2 i kësaj rregulle përcakton se raporti i pranimit të mallit/shërbimit nga zyrtari apo komisioneri i autorizuar duhet t'i dorëzohet Zyrës përmes buxhetit dhe financa (së bashku me kontratën dhe urdhërblerjen).

Sipas nenit 3 të marrëveshjes të Komunës me UNDP, kontributi do të administrohet nga UNDP në përputhje me rregulloren, rregullat, politikat dhe procedurat e UNDP, duke zbatuar procedurat e tij përmes ekzekutimin e projekteve të tij, dhe sipas nenit 6 të kësaj marrëveshje kontributi do t'i nënshtrohet ekskluzivisht procedurave të auditimit të brendshëm dhe të jashtëm të parashikuara në rregulloren, rregullat, politikat dhe procedurat financiare të UNDP. Ndërkohë, sipas nenit 5 të marrëveshjes pronësia e pajisjeve, furnizimeve dhe pronave të tjera të finansuara nga kontributi do t'i kalojë UNDP-së. Çështjet që kanë të bëjnë me kalimin e pronësisë nga UNDP do të përcaktohen në përputhje me politikat dhe procedurat përkatëse të UNDP-së.

- Komuna, me datë 05.09.2024 ka hyrë në marrëveshje kontraktuale me UNDP-në përmes realizuar projektet: 1. Ndërtimi i Sallës multifunksionale (Tulltorja); dhe 2. Sallës koncertuale të ish objekti i Gërmisë. (Modernizimi i arsimit përmes inovacionit dhe trashëgimisë). Këto projekte është planifikuar të përfundojnë me 31 gusht të vitit 2025. Përmes kësaj marrëveshje, Komuna ishte dakorduar me UNDP që në kundërvlerë të projektit t'i transferoj në formë parapagimi një vlerë të kostos prej 5,120,000€. Përderisa, sipas një raporti të progresit të UNDP-së, kjo e fundit do të përcaktohet me vlerë 100,000€, vlerë e cila nuk ishte e përfshirë fare në marrëveshje. Menaxhimi dhe përgjegjësia e zbatimit të procedurave përmes ekzekutimin e projektit i ishte ngarkuar UNDP-së.

Kjo marrëveshje, ishte në kundërshtim me Ligjin e Prokurimit Publik dhe Ligjin e Buxhetit për vitin 2024 për shkak se Komuna kishte deleguar të gjitha përgjegjësitë për zhvillimin e procedurave të prokurimit tek UNDP, por edhe kishte transferuar në formë të parapagimit të gjitha fondet tek UNDP.

Për më tepër, procesi i transferëve të fondeve ishte zhvilluar në mungesë të raporteve të pranimit të furnizimeve, punëve dhe shërbimeve.

Transferi i vlerës se përgjithshme të fondeve prej 5,120,000€ është realizuar, si në vijim:

- Në shtator, 3 pagesa në vlerë 900,000€,
- Në tetor 3 pagesa në vlerë 1,200,000€,
- Në nëntor 2 pagesa në vlerë 300,000€; dhe
- Në dhjetor 3 pagesa në vlerë 2,720,000€.

Më datë 19 shkurt 2025 është hartuar një raport tre mujor i progresit të projekteve, që mbulon periudhën shtator - dhjetor 2024, përmes së cilit kemi vërejtur se projekt pothuajse ende nuk ka filluar. Se projekt ende është në fazën fillore të projektimit e konfirmon edhe Komuna përmes komunikimit elektronik.

Kemi iniciuar procedurën e ekzaminimit fizik për të verifikuar progresin e punimeve, furnizimeve dhe shërbimeve, por sipas Komunës, projektet për rehabilitimin e ndërtuesës së Gërmisë dhe objektit të Tulltorës janë ende në fazën e projektimit dhe punimet nuk kanë filluar.

- Në datën 07.05.2024 Komuna ka lidhur një marrëveshje financimi me UNDP-në për projektin “Fuqizimi Institucional i Komunës së Prishtinës”, në vlerë prej 80,000€ për kontraktimin e shërbimeve të veçanta për angazhimin e ekspertëve. Pagesa është realizuar nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve pa aplikuar procedura të prokurimit dhe në formë të paradhënieve, ndërkëq mungojnë dëshmi për të justifikuar pranimin e shërbimeve.

Komuna ka paraqitur vetëm një raport të përgjithshëm tremujor të progresit, i cili nuk është i datuar, nuk është protokolluar, nuk përmban informacion teknik apo narrativ të detajuar për shërbimet e ofruara nga ekspertët e angazhuar (ekspert për menaxhimin e aseteve, planifikimit urban, çështjet ligjore). Gjithashtu, mungojnë kontratat individuale, raportet e angazhimit dhe dëshmitë e pagesave për këta ekspertë, duke e bërë të pamundur verifikimin real të kontributit të tyre në kuadër të projektit.

Këto kanë ndodhur si rezultat i shmangjes së zbatimit të kërkesave ligjore për kontraktimin dhe pranimin e punëve dhe shërbimeve, dhe si pasojë e kontrolleve të dobëta të brendshme. Gjithashtu, marrëveshjet e bashkëpunimit nuk kanë përfshirë specifikime të qarta për të drejtat dhe detyrimet e palëve, duke lënë hapësirë për paqartësi në mënyrën e zbatimit dhe verifikimit të shërbimeve të kryera.

Ligjit të Buxhetit dhe procedurave të tjera përkatëse, si; raporte të pranimit të punëve apo shërbimeve dëmton parimet e konkurrencës dhe transparencës në menaxhimin e fondeve publike. Kjo mundëson anashkalim të mbikëqyrjes dhe përdorim të këtyre fondeve në mënyrë të pa kontrolluar duke rrezikuar arritjen e qëllimit dhe keq menaxhimin e fondeve. Gjithashtu, një praktikë e tillë e transferimit të fondeve në kundërshtim më kornizën ligjore të aplikueshme hap mundësi të mëdha të shpenzimit të buxhetit pa realizuar vlerën për para.

Rekomandimi A6 Kryetari duhet të sigurojë që shpenzimi i fondeve publike të bëhet në përputhje të plotë me legjislacionin e aplikueshëm për menaxhimin e financave publike. Çdo kontraktim i punëve apo shërbimeve duhet të realizohet përmes procedurave të rregullta të prokurimit, ndërsa çdo pagesë duhet të mbështetet në një raport të pranimit të mallrave apo shërbimeve.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A7 - Lidhja e kontratës për projektim pavarësisht ekzistencës së kontratës aktuale për shërbime të ngjashme

Gjetja Komuna më datë 27.03.2023 ka lidhur kontratë me titullin “Konsulencë për themelimin e shërbimit të arkitektit të kryeqytetit për nevojat e Komunës së Prishtinës” me vlerë 12,000,000€. Kjo kontratë përfshin përgatitjen për standardizimin dhe dizajnin e projekteve të ndërtimit, planeve urbanistike, hartave zonale. Gjithashtu përfshin edhe konsulencë dhe projekte të arkitekturës për nevoja emergjente të Kryeqytetit, organizimin e konkurseve, ekspozitave, angazhim të ekipeve vlerësuese, shërbime ndihmëse profesionale për nevojat e drejtive, etj.

Gjatë auditimit kemi vërejtur se më 21.02.2024, Komuna kishte lidhur një kontratë me vlerë 1,200,000€ për konkursin dhe projektimin e objektit “Art & Technology Hub - Tulltorja”. Kjo kontratë përfshin katër faza të plota të projektimit: projekt i ideor i përpunuuar, projekt skematik, projekt zbatues dhe plotësimi i dokumentacionit sipas kërkesave të Drejtorisë së Urbanizmit.

Shërbimet e përfshira në këtë kontratë janë të natyrës së njëjtë me ato të përfshira në kontratën ekzistuese “Konsulencë për themelimin e shërbimit të arkitektit të Kryeqytetit për nevojat e Komunës së Prishtinës” në vlerë prej 12,000,000€ e cila mbulon edhe nevoja të tilla projektimi varësisht kërkesave të Komunës.

Ky projekt nuk ishte i paraparë as në planifikimin e prokurimit, ndërsa nuk kemi marrë arsyeshmëri nga njësia e kërkesës.

Kjo kishte ndodhur si rezultat i mungesës së kontrolleve lidhur me vlerësimin dhe vendosjen e specifikave për projekte në procesin e tenderimit.

Ndikimi Lidhja e kontratës për projektim pavarësisht ekzistencës së kontratës aktuale për shërbime të ngjashme rrit rrezikun për mbivendosje të shërbimeve dhe shpenzime të dyfishta për të njëjtat qëllime.

Rekomandimi A7 Kryetari duhet të sigurojë që para inicimit të kontratave të reja, të bëhet një analizë e plotë e mbulueshmërisë së kontratave ekzistuese, për të

shmangur mbivendosjen dhe dyfishimin e shërbimeve.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A8 - Dobësi në menaxhimin e kontratave “Në shtëpi”

Gjetja

Sipas nenit 2, pika 3 të kontratës “Në shtëpi” për menaxhimin e Qendrës për trajtimin e qenve endacak, të lidhur ndërmjet Komunës së Prishtinës dhe NPL “Gjelbër”, me datë 29.03.2024, thuhet se: “Çmimet për shërbimet e kryera sipas kësaj kontrate nuk mund të ndryshojnë nga çmimet e dakorduara përmes kësaj kontrate.” Sipas nenit 9 të kësaj kontrate, faturat duhet të dorëzohen pas përfundimit të shërbimeve, dhe pagesa bëhet vetëm pas pranimit të dokumentacionit përkatës.

Ndërkaq, në nenin 6 të kontratës “Në shtëpi” me NPL “Pallati i Rinisë” sh.a, e lidhur më 13.07.2023, kërkohet që ndërmarrja të dorëzojë raporte mujore që do të verifikohen dhe monitorohen nga autoriteti kontraktues përmes menaxherit të kontratës.

Në tri raste kemi identifikuar mangësi në zbatimin dhe mbikëqyrjen e kontratave “Në shtëpi”:

- Gjatë auditimit kemi vërejtur se Komuna ka realizuar pagesën në vlerë prej 50,000€ në emër të kontratës “Në shtëpi” me NPL “Gjelbër” për blerjen e dy veturave për kapjen e qenëve endacak. Megjithatë, nga dokumentacioni i siguruar gjatë auditimit, rezulton se vlera e kontraktuar dhe e paguar për veturat nga Ndërmarrja për blerjen e veturave ka qenë 44,400€. Pavarësisht kësaj, në konstatimin e bërë nga menaxheri i kontratës në Komunë, është raportuar se furnizimi është bërë në vlerë të plotë 50,000€, pa ndonjë sqarim për diferençën se si janë shfrytëzuar ato mjete prej 5,600€ nga Ndërmarrja;
- Ndërsa, tek pozicioni 19 për pajisje për infrastrukturën e brendshme (dollapë, frigorifer, llambë kirurgjikale, etj.) në vlerë 30,000€, Komuna kishte kryer pagesën bazuar në faturë dhe kontratë, mirëpo dokumentacioni mbështetës tregonte çmime të ndryshme nga ato të faturuara nga Ndërmarrja. Si p.sh: frigoriferi ishte faturuar 1,635€, ndërsa në kontratën e Ndërmarrjes me OE figuron 1,178€; llamba kirurgjikale (montim në tavan) ishte faturuar 4,000€, ndërsa kontrata e furnizimit e tregon në vlerë prej 3,304€. Gjatë verifikimit në terren, nuk është arritur të konfirmohen furnizimet për shkak të mungesës së specifikimeve teknike, numrave serik dhe dokumentacionit përcjellës. Llamba e instaluar nuk ishte e montuar në tavan, por me një version të lëvizshëm, që bie në kundërshtim me përshkrimin në faturë. Gjithashtu, për gati tre muaj pas lidhjes së kontratës (deri më 21.06.2024), nuk kishte organ të emëruar për mbikëqyrjen e saj.

Në të dyja rastet, Komuna nuk ka pasur ndonjë mekanizëm monitorimi për të ndjekur si janë shfrytëzuar nga Ndërmarrja këto mjete shtesë.

- Gjatë auditimit kemi vërejtur se dy pagesa në vlerë totale prej 36,108€ janë realizuar nga Komuna ndaj Ndërmarrjes Publike Lokale “Pallati i Rinisë”, për pagesën e qirasë së sallave të sportit dhe zyrave, të destinuara për zhvillimin e aktiviteteve kulturore dhe sportive. Pagesat janë ekzekutuar vetëm me kërkesë të Kryetarit të

Komunës, pa pasur paraprakisht një raport pranimi nga menaxheri i kontratës, siç kërkohet qartë në kontratë. Për më tepër, menaxheri i kontratës është caktuar me një vonesë prej rreth pesë muajsh pas nënshkrimit të kontratës.

Dobësitë e identifikuara kanë ndodhur si rezultat i mungesës së një mekanizmi funksional për mbikëqyrjen dhe kontrollin e kontratave “Në shtëpi”. Komuna nuk ka vendosur procedura të qarta për monitorimin e realizimit të kontratave, nuk ka siguruar emërimin me kohë të menaxherëve të kontratave dhe nuk ka aplikuar kontrollin e dokumentacionit mbështetës për justifikimin e pagesave.

Ndikimi	Dobësitë e lartë përmendura rrisin rrezikun në sigurimin e përdorimit të drejtë të parasë publike. Po ashtu, vonesat në emërimin e menaxherëve të kontratave kanë dobësuar kontrollin dhe përgjegjësinë institucionale, ndërsa mungesa e mekanizmave të monitorimit ka bërë që Komuna të mos ketë informacion të plotë dhe të verifikueshëm mbi mënyrën e shfrytëzimit të mjeteve të ndara për ndërmarrjet publike. Kjo gjithashtu mund të krijojë precedentë të dëmshëm për praktika të ngjashme në të ardhmen.
Rekomandimi A8	Kryetari duhet të sigurojë krijimin dhe funksionimin e mekanizmave të qartë për monitorimin dhe mbikëqyrjen e kontratave “Në shtëpi”. Duhet të garantohet që çdo pagesë të realizohet vetëm pas verifikimit të plotë teknik, administrativ dhe financiar të furnizimeve. Po ashtu, duhet të dokumentohet dhe qartësohet përdorimi i mjeteve të mbeturë ose të paspenzuara dhe të sigurohet emërimi në kohë i menaxherëve të kontratave, për të parandaluar situata të ngjashme në të ardhmen.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B4 - Mosrespektimi i hapave për procedimin e pagesave

Gjetja	Sipas Rregullës finanziare nr. 01/2013 për shpenzimin e parasë publike, nen 22, janë përcaktuar hapat për procedimin e pagesave, ku fillimisht bëhet kërkesa për blerje, lëshohet urdhërblerja, bëhet pranimi i mallit/shërbimit, pastaj operatori ekonomik sjellë faturën për pagesë.
---------------	--

Gjatë auditimit, kemi vërejtur se këto hapa nuk janë respektuar në rastet si më poshtë:

- Në 31 raste të pagesave⁷ në vlerë 4,382,079€ nuk ishin respektuar hapat e përcaktuara për procedim të pagesave, pasi që urdhërblerjet ishin procesuar pas pranimit të faturës; dhe
- Në 27 raste të pagesave në vlerë 3,172,852€ zotimet ishin hartuar dhe nënshkruar pas pranimit të faturës.

Kjo dukuri ka ndodhur si rezultat i kontrolleve joefektive, për faktin që nuk janë zbatuar procedurat ligjore për shpenzimin e parasë publike nga ana e zyrtarëve përgjegjës.

Ndikimi	Mos aplikimi i procedurave të duhura të kontrollit gjatë procesit të pagesave, mund të ndikojë që komuna mos t'i kryej obligimet e faturuara me kohë, rrjedhimisht rritjen e obligimeve të papaguara, të cilat do të jenë barrë për buxhetin e vinit vijues dhe vonesa në pagesa.
----------------	---

Rekomandimi B4	Kryetari duhet të sigurojë se respektohen hapat e përcaktuar me rregullat në fuqi për procedimin e pagesave nga zyrtarët përgjegjës, në mënyrë që fillimisht të bëhet zotimi i mjeteve, të nxjerret urdhërblerja dhe më pas pranimi i mallrave/punëve.
-----------------------	--

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B5 - Përzgjedhja e operatorëve ekonomik të papërgjegjshëm gjatë vlerësimit të ofertave në procedurat e prokurimit

Gjetja	Sipas nenit 59.4 të LPP-së, autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë.
---------------	--

Rregullorja 001/2022 për prokurim publik, neni 26.6 kërkon nëse Autoriteti Kontraktues kërkon çertifikata të hartuara nga organe të pavarura që kryejnë aktivitete të certifikimit përfunduar se operatori ekonomik përmbush standarde të caktuara përfundim e cilësisë që bazohen në standarde kosovare, evropiane ose ndërkombëtare, secili anëtar i grupit do të dëshmoj se i përmbush standardet përkatëse.

Në tri (3) procedura të prokurimit, kemi vërejtur mangësitë në procesin e vlerësimit, si në vijim:

- Tek Konkursi i projektimit “Art & Technology Hub - Tulltorja”, kontrata e nënshkruar në vlerë prej 1,200,000€ në dosje të tenderit është kërkuar që OE Sipas nenit 59.4 të LPP-së, autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë. Rregullorja 001/2022 përfunduar se operatori ekonomik përmbush standarde të caktuara përfundim e cilësisë që bazohen në standarde kosovare, evropiane ose ndërkombëtare, secili anëtar i grupit do të dëshmoj se i përmbush standardet përkatëse. Duhet të ofroj dëshmi për stafin profesional si: Dy (2) Inxhinier të Diplomuar të Arkitekturës - MSc në Arkitekturë (300 ECTS) me përvojë pune në projektim minimumi 5 vite pas diplomimit, të kenë referenca në punë të natyrës se ngjashme. Gjatë auditimit kemi vërejtur se përfundimisht e propozuar mungonin referencat që dëshmojnë përvojën e tyre në projekte të ngjashme. Kjo bie ndesh me kërkesat e përcaktuara në dosjen e tenderit dhe përbën mangësi në vlerësimin e kapaciteteve të stafit të propozuar.

Për më tepër, gjatë intervistave me zyrtarët përkatës, është vërejtur se komisioni i vlerësimit kishte analizuar vetëm pjesën e konceptit të projektit dhe jo tërë dokumentacionin e ofertës si dokumentacionin që vërteton përmbushjen e kriterieve të përshtatshmërisë teknike dhe profesionale. Anëtarët e komisionit deklaruan se kishin vlerësuar vetëm pjesën krijuese (konceptin), pa hyrë në aspektet ligjore dhe teknike të dokumentacionit. Megjithatë, raporti i vlerësimit të tenderit ishte i nënshkruar nga të gjithë anëtarët e komisionit të vlerësimit;

- Në dosjen e tenderit për projektin “Ndërtimi i rrugëve në lagjen Kodra

e Trimave”, kontrata e nënshkruar në vlerë prej 598,764€ më 08.07.2024 tek kërkesat mbi mundësítë teknike dhe profesionale është kërkuar që OE duhet të dëshmojë së është i certifikuar me ISO 9001-2015. Ne kemi vërejtur se OE fitues në listën e certifikatave ISO kishte sjellë vetëm të anëtarit të katërt të konzorciumit, por jo edhe të anëtarëve të tjerë dhe anëtarit lider siç kërkohet. Përpos kësaj, për disa pozita kyçe si: Menaxher Projekti, Inxhinier Ndërtimi (konstruktiv), Inxhinier Gjeodezie, dhe Inxhinier Hidroteknik ishte kërkuar përvojë profesionale e dëshmuar me kontrata pune. OE fitues kishte dorëzuar vetëm referencat mbi përvojën e punës, jo edhe kontratat; dhe

- Në dosjen e tenderit për projektin “Renovime per Qendra te ndryshme Sociale ne lagjet Kodra e Trimave, Tophane, Qafa, Aktash, Pejton, Ulpiana”, kontrata e nënshkruar në vlerë të parashikuar prej 100,000€, çmim të poentuar 13,197€ në listën e pajisjeve të kërkuaara ishte kërkuar një kamion kran dhe kiper me peshë bartëse min. 2 ton. OE fitues kishte ofruar pajisje me qira, por numri i shasisë në marrëveshje nuk përputhej me atë në librezë, duke dëshmuar se mjeti nuk ishte ai që është kontraktuar. Gjithashtu, kërkesa për një inxhinier elektroteknik me përvojë min. 5 vjet pas diplomimit nuk ishte dëshmuar në përputhje me specifikimet në dosjen e tenderit.

Këto mangësi kanë ndodhur për shkak të një procesi të dobët të vlerësimit nga komisionet përkatëse. Mungonte kuptimi i quartë i kritereve të përcaktuara në dosjet e tenderit, interpretimi i tyre korrekt dhe aplikimi i tyre në përputhje me kërkesat sipas dosjes së tenderit.

Gjithashtu, u vërejt mungesë e kontrollit të brendshëm nga zyrtarët përgjegjës për të verifikuar përputhshmérinë e dokumentacionit dhe për të parandaluar nënshkrimin e raporteve të vlerësimit me gabime.

Ndikimi

Përzgjedhja e operatorëve ekonomikë që nuk i plotësojnë kriteret e përcaktuara mund të rezultojë në realizim me cilësi të dobët të kontratave publike, dëmtim të integrititetit të procesit të prokurimit, mungesë sigurie për përbushjen e detyrimeve të OE-ve, dhe humbje e mundësisë për tërheqjen e sigurisë së tenderit në rast të mos përbushjes së kushteve kontraktuale.

Rekomandimi B5

Kryetari duhet të sigurojë forcimin e kontrolleve në fushën e prokurimit, në mënyrë që vlerësimi i ofertave të bëhet në pajtueshmëri të plotë me kërkesat e vendosura në dosjet e tenderit dhe në pajtueshmëri me kërkesat ligjore. Po ashtu, përmes zyrtarëve përgjegjës të sigurojë se anëtarët e komisioneve i kuptojnë detyrat dhe përgjegjësitë e tyre në angazhimet përkatëse, dhe në rast të gabimeve eventuale këto të evidentohen nga zyrtarët e prokurimit para nënshkrimit të raportit të vlerësimit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B6 - Ndryshimet buxhetore për projekte kapitale pa aprovimin e Kuvendit Komunal

Gjetja

Sipas nenit 16 paragrafi 11, të ligjit të buxhetit nr 08/L-260 për vitin 2024 ndryshimet në shumat e ndara buxhetore për projektet ekzistuese si rezultat i transfereve dhe/ose rialokimeve, të prezantuara në tabelën 4.2. duke përfshirë edhe të hyrat vetanake të bartura, si dhe të regjistruara në SIMFK, duhet të aprovojen paraprakisht nga Kuvendi Komunal.

Gjatë auditimit kemi vërejtur se për 17 pagesa të investimeve kapitale, me vlerë totale 3,400,807€, fondet janë marrë nga projekte të tjera të aprovuara në ligjin e buxhetit. Në 11 raste⁶, në vlerë 2,178,572€, pagesat janë realizuar me urdhëresë të Kryetarit të Komunës, bazuar në kërkesat e drejtoreve përkatëse.

Mirëpo, për këto ndryshime nuk është marrë aprovimi paraprak nga Kuvendi Komunal, siç kërcohët me ligj.

Kjo ka ndodhur për shkak të mospërfilljes së kërkesave ligjore nga ana e menaxhmentit të Komunës për sigurimin e aprovimit të Kuvendit para ndryshimeve buxhetore.

Ndikimi	Marrja e vendimeve për ndryshime buxhetore pa miratim të Kuvendit Komunal e dobëson transparencën dhe llogaridhëni në procesin e menaxhimit të financave publike. Kjo qasje, gjithashtu, rrezikon zbatimin e projekteve ekzistuese, pasi mund të mbeten pa financim të mjaftueshëm përfundimin e tyre.
Rekomandimi B6	Kryetari duhet të sigurojë që për çdo ndryshim në shumat buxhetore të projekteve të aprovuara në ligjin e buxhetit, të merret paraprakisht aprovimi nga Kuvendi Komunal, në përputhje me kërkesat ligjore

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B7 - Vonesa në realizimin e projekteve kapitale

Gjetja Sipas nenit 70.23 të Rregullës nr. 001/2022 për prokurimin publik, menaxheri i kontratës do të sigurojë se Operatori ekonomik kryen kontratën në përputhje me termat dhe kushtet e specifikuara në kontratë.

Në kontratat e nënshkruara ndërmjet Komunës dhe operatorëve ekonomik përcaktohet afati kohor për realizimin e punimeve.

Po ashtu, sipas nenit 29 të Rregullores për prokurim publik, përcaktohet që siguria e ekzekutimit është paraparë të mbështesë përbushjen e kontratës, ndërsa neni 29.6 thekson se sigurimi i ekzekutimit do të mbetet valid për një periudhë prej tridhjetë (30) ditë pas kompletimit të kontratës.

Në nëntë (9) raste kemi vërejtur se punimet nuk ishin realizuar konform planit dinamik siç parashihej me kontratë. Rastet e identifikuara janë:

- Kontrata “Konkurs projektimi - Tulltorja” me vlerë prej 1,200,000€ ishte nënshkruar më 21.02.2024 me datë të përfundimit të punimeve 9 muaj nga data e nënshkrimit të kontratës, ende nuk kishte përfunduar. Si rrjedhojë e vonesave sigurimi i ekzekutimit bankar në vlerë prej 120,000€ kishte skaduar më datë 21.12.2024;
- Kontrata “Ndërtimi i urave në pjesën perëndimore të unazës qendrore” në vlerë prej 3,298,455€, data e nënshkrimit të kontratës është 14.03.2024 me datë të përfundimit të punimeve 120 kalendareke nga nënshkrimi i kontratës, deri gjatë kohës sa ishim në auditim ende nuk kishte përfunduar;

- Kontrata “Implementimi i planit të mobilitetit” me vlerë prej 727,167€ ende nuk ishte përfunduar, ndërsa plani dinamik ishte 120 ditë nga data e nënshkrimit të kontratës 25.03.2023;
- Kontrata “Ndërtimi i shkollës 7 shtatori” me vlerë të kontaktuar prej 1,878,000€ dhe dy aneks kontrata prej 55,635.30€ dhe 132,100€ - data e nënshkrimit të kontratës bazë 23.03.2023 dhe aneksit të dytë 17.09.2024 me afat prej 210 ditë, gjegjësisht 30 ditë ende nuk ka përfunduar;
- Kontrata “Rikonstruimi i rrugëve Mic Sokoli dhe 27 nëntori - Lot 1” me vlerë të kontraktuar prej 378,816€, me plan dinamik 120 ditë nga data e nënshkrimit të kontratës 02.08.2023 ende nuk ishte përmbyllur;
- Kontrata “Ndërtimi i krahëve të rrugës Muharrem Fejza” me vlerë prej 486,448€, me plan dinamik 90 ditë prej nga data e nënshkrimit të kontratës 08.05.2023, ende nuk kishte përfunduar;
- Kontrata “Ndërtimi i strehimores - parku i qenëve - Negociuar” me vlerë të kontraktuar prej 410,000€, ende nuk ishte përmbyllur edhe pse plani dinamik ishte 60 ditë nga data e nënshkrimit të kontratës 17.09.2024, ende nuk ishte përmbyllur;
- Kontrata “Ndërtimi i kolektorit te vazhdimi i rrugës B (faza e 4) me vlerë të kontratës prej 399,700€, ende nuk kishte përfunduar ani pse me plan dinamik data e përfundimit të punimeve është 60 ditë kalendarike nga data e nënshkrimit të kontratës 22.04.2024; dhe
- Kontrata “Ndërtimi i fushave sportive në Komunën e Prishtinës - Fusha në Hajvali” me vlerë të kontraktuar 262,930€, ende nuk kishte përfunduar edhe pse sipas planit dinamik është 90 ditë kalendarike nga data e nënshkrimit të kontratës 08.11.2023.

Vonesat në realizimin e projekteve kishin ndodhur si rezultat i ngecjeve të punimeve për shkak të paraqitjes së nevojave për punë shtesë, lidhjes së kontratave pa u pajisur me lejet ndërtimore, vendosjës së afateve për realizim të projekteve pa një analizë të duhur, si dhe mos përputhjes së projekteve dhe pozicioneve të kontratës me gjendjen faktike. Ndërsa, mos zgjatja e afatit të sigurimit të ekzekutimit rrezikon afatin e përbushjes së kontratës.

Ndikimi

Vonesat në realizimin e projekteve ndikojnë në mosarritjen e objektivave të komunës, dhe pamundësinë e shfrytëzimit të këtyre projekteve të cilat janë në shërbim të qytetarëve të komunës.

Ndërkaq, skadimi i afatit të mbulueshmërisë së sigurimit të ekzekutimit deri në përfundim të projektit rrezikon që komuna të mos ketë mbulesë për dëmet dhe shpenzimet eventuale, dhe pamundëson ndëshkimin eventual ndaj operatorëve në rastet kur kontrata nuk përbushet.

Rekomandimi B7

Kryetari duhet të sigurojë se para inicimit të projekteve për punë, të përbushen kushtet e realizimit projektit siç janë, pajisja me lejet e nevojshme për punë, zgjidhja e çështjeve pronësore, hartimi i mirëfilltë i projekteve ekzekutuese për t'u minimizuar kërkuesat për punë të pa parapara, si dhe të forcohen kontrolllet në mbikëqyrjen e vazhdueshme të progresit të projekteve, në mënyrë që punët të realizohen sipas planeve dinamike dhe sigurimet e ekzekutimit të ofruara nga operatorët ekonomik të mbulojnë periudhën deri në 30 ditë pas kompletimit të kontratës.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B8 - Ndryshimet në kushtet e kontratës pa aprovimet e duhura

Gjetja

Sipas nenit 71.1 të Rregullores për prokurim publik nr. 001/2022, Ndryshimi i kontratës i referohet një ndryshimi në termat dhe kushtet e një kontratë të shpërblyer. Ndryshimi i kontratës iniciohet nga menaxheri i kontratës. Në rast të kontratave për punë nevojitet aprovimi paraprak i projektuesit.

Ndryshimi i kontratës nuk do t'i lëshohet Operatorit ekonomik para marrjes së aprovimit nga ZKA dhe zotimit të mjeteve për kontratën e ndryshuar.

Ne kemi vërejtur se në dhjetë (10) kontrata për punë identifikuar kishte pasur ndryshime të sasive të realizuara nëpër disa pozicione, duke rritur/zvogëluar sasinë e kontraktuar apo në disa raste duke mos realizuar fare pozicionet e kontraktuara, por pa rritur çmimin total të kontratës, të autorizuara nga menaxherët e kontratave. Për këto ndryshime, nuk kishte amandamentim të kontratës.

Ndryshimet në sasitë e kontraktuara kishin ndodhur në kontratat si në vijim:

- Në kontratën "Ndërtimi i rrugës A - pjesa e parë" në vlerë 8,497,801€, kishte rritje të sasive të realizuara në pesë pozicione të kontratës në vlerë 102,307€, apo deri në 284% rritje të sasive në pozicionet e kontraktuara;
- Në kontratën "Implementimi i planit të mobilitetit në vlerë 727,167€, kishte rritje të sasive të realizuara në 11 pozicione të kontratës në vlerë 85,078€, apo deri në 181% rritje të sasive në pozicionet e kontraktuara;
- Në kontratën "Rregullimi i varrezave të dëshmoriёve në Viti të Marecit - Prishtinë" në vlerë 537,892€, kishte rritje të sasive të realizuara në 14 pozicionet e kontraktuara ku rritja ishte në vlerë 4,518€, apo deri në 694% të sasisë për pozicionet e kontraktuara;
- Në kontratën "Ndërtimi i rrugëve Prugovc-Lebane-Barilevë" në vlerë 264,470€, rritja e sasive të kontraktuara në 17 pozicione në vlerë 4,816€, apo deri në 24% të sasisë për pozicionet e kontraktuara;
- Në kontratën "Rikonstruimi i rrugëve në rrugën Mic Sokoli dhe 27 Nëntori" në vlerë 378,816€, kishte rritje të sasisë në dy pozicionet e kontraktuara me vlerë gjithsej 10,529€, apo deri në 68% të sasisë për pozicionet e kontraktuara;
- Në kontratën "Renovimi i hapësirës lokacioni tek Drejtoria e rrugëve Bregu i Diellit - Prishtinë", në vlerë 417,638€, kishte rritje të sasisë në 12 pozicione të kontraktuara, në vlerë 66,661€, apo deri në 456% të sasisë për pozicionet e kontraktuara;
- Në kontratën "Ndërtimi i krahëve të rrugës Muharrem Fejza" në vlerë 486,448€ kishte rritje të sasisë në shtatë pozicione në vlerë 24,118€, apo deri në 2,745% rritje të sasive në pozicionet e kontraktuara;
- Në kontratën "Ndërtimi i rrugës në Radashevc" në vlerë 253,366€ kishte rritje të sasisë në tri pozicione në vlerë 2,612€, apo deri në 15.76% rritje të sasive në pozicionet e kontraktuara;
- Në kontratën "Ndërtimi i aneksit të shkollës Pavarësia" në vlerë prej 879,554€ kishte rritje në katër pozicione në vlerë prej 13,201€ apo deri në 311%; dhe
- Në kontratën "Ndërtimi i tribunës për klubin futbollistik KF Ramiz Sadiku" në vlerë 199,386€ kishte rritje të sasisë në nëntë pozicione

në vlerë 5,264€, apo deri në 153.7% rritje të sasive në pozicionet e kontraktuara.

Këto kishin ndodhur si rezultat i mosfunkcionimit të kontrolleve në menaxhimin e kontratave, mos planifikimit të mirëfilltë të projekteve dhe ndryshimeve në kushtet e terrenit me mendimin për t'i bërë projektet më funksionale.

Ndikimi Ndryshimi i paramasës së kontraktuar, në mungesë të aprovimeve të duhura dhe dëshmive se janë bërë analiza specifike për këto ndryshime, rezikon që realizimi i punëve të mos jetë konform kërkesave të projektit dhe krijon mundësinë për manipulime me pozicionet dhe paramasat e tenderit fillestar.

Kjo rrjedhimisht mund të shpie në tejkalimin e kontratës.

Rekomandimi B8 Kryetari duhet të forcojë llogaridhënien lidhur me menaxhimin e projekteve kapitale, duke siguar se për cdo ndryshim në termat dhe kushtet e kontratës, të zbatohen procedurat për marrjen e aprovimeve të duhura sipas rregullave të prokurimit të aplikueshme dhe amandamentimin e kontratës në pajtim me ndryshimet e bëra.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B9 - Realizimi i sasive në kontratat publike kornizë, në mospërputhje me peshët e përcaktuara në dosjen e tenderit

Gjetja Sipas nenit 17.35 të Regullores nr.001/2022 për prokurimin publik, Kurdo që Autoriteti kontraktues nuk din sasitë indikative, kontratat me çmime për njësi, AK duhet të përcaktoj peshët në bazë të rëndësës së secilës "kategori të shërbimeve" në mënyrë që AK të përcaktoj se cila është oferta me çmim më të ulët në bazë të poentimit.

Si rrjedhojë, peshimi i artikujve duhet bërë bazuar në peshën dhe rëndësinë e kategorisë përkatëse, që do të thotë se sasia e realizuar (shpenzuar) nuk mund dhe nuk duhet të ndryshoj nga raportet sipas peshës së dhënë në Dosjen e Tenderit.

Menaxheri i kontratës mbetet përgjegjës që të dëshmoj në mënyrë të qartë se sasia e porositur dhe shpenzuar është në harmoni me peshën e dhënë dhe me nevojat reale të AK.

Në tri (3) kontrata publike kornizë me çmime për njësi, vlera e shpenzuar e një kategorie të caktuar, janë evidentuar raste ku vlera e shpenzuar për një kategori të caktuar ka tejkaluar vlerën e lejuar në bazë të peshimit sipas kontratës. Bëhet fjalë për kontratat si në vijim:

- Në kontratën "Ndërtimi i rrrethojave për siguri në mobilitet" me vlerë të parashikuar 1,200,000€, kategoria B e specifikave është peshuar me 40% të kontratës apo lejim të shpenzimit deri në vlerë 480,000€, ndërsa ishte tejkaluar duke u realizuar në vlerë 889,613€ apo 74% e vlerës se kontratës;
- Në kontratën "Investimi dhe rregullimi i hapësirave publike faza e II-të" në vlerë indikativë 1,000,000€ me çmim total të poentuar 55,091€, kategoria A e specifikave është peshuar me 60% të kontratës apo

lejim të shpenzimit deri në 600,000€ ishte tejkaluar duke u realizuar në vlerë prej 767,851€ apo 79%. Ndërsa, kategoria B e peshuar me 40% apo 400,000€ të vlerës së kontratës, është realizuar me 513,790€ apo 51%.

Për më tepër, totali i pagesave ka arritur 1,281,641€, që përfaqëson një tejkalim prej 28% të vlerës të kontratës. Kjo bie ndesh me parimin ligjor që në kontratat kornizë me peshim, nuk aplikohet toleranca plus/minus 30% si në kontratat me sasi indikative; dhe

- Në kontratën “Sinjalizimi horizontal dhe vertikal llot II”, në vlerë indikativë 450,000€, kategoria A e specifikave është peshuar me 80% të kontratës apo lejim të shpenzimit deri në vlerë 360,000€, ndërsa ishte tejkaluar duke u realizuar në vlerë 535,409€ apo 119% e vlerës se kontratës.

Këto tejkalime kishin ndodhur si pasojë e planifikimit jo të mirë të nevojave, përcaktimit jo të duhur të peshimit të kategorive në bazë të rëndësise së punëve/shërbimeve në dosjen e tenderit dhe mungesës së kontrollit nga menaxherët e kontratave gjatë zbatimit të kontratës.

Ndikimi Tejkalimi i shpenzimit të sasive të lejuara sipas peshës që iu është caktuar në dosjen e tenderit dhe në kontratë, ndikon në mungesë të transparencës në vendimmarrjen për zgjedhjen e ofertës me çmimin më të ulët.

Kjo ndodh sepse vendimi për dhënen e kontratës është bazuar në një strukturë çmimi të balancuar sipas peshës së paraparë, ndërkohë që në realizim ato nuk respektohen.

Si pasojë, komuna rrezikon planifikimin buxhetor, duke hyrë në obligime shtesë të paparashikuara.

Rekomandimi B9 Kryetari duhet të sigurojë përmes njësive kërkuese, të bëhet një vlerësim i saktë i nevojave reale të komunës gjatë përgatitjes së kërkesave për tender dhe peshat e specifikuara në dosjet e tenderit të reflektojnë rëndësinë dhe vëllimin e pritshëm të shërbimeve që do të kryhen në praktikë. Gjatë zbatimit të kontratës, menaxherët e kontratave të monitorojnë zbatimin sipas peshave të miratuar, për të garantuar përputhshmëri të plotë me kërkuesat ligjore dhe objektivat buxhetore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B10 - Vonesat në pagesën e faturave dhe kostoja shtesë për komunën si resultat i ekzekutimit të pagesave përmes vendimeve gjyqësore dhe përmbarimore

Gjetja Sipas nenit 39 të LMFPP-së, përcaktohet se ZKF i Organizatës Buxhetore është përgjegjës për të siguruar që çdo faturë e vlefshme dhe kërkësë për pagim për mallra dhe shërbimet e furnizuara dhe/ ose punët e realizuara për OB-në të paguhen brenda 30 ditëve kalendarike pas pranimit të faturës ose kërkësës për pagim.

Ndërsa sipas nenit 40 të LMFPP, fatura mund të ekzekutohet direkt nga Thesari pas marjes së urdhrit të prerë nga gjykata/ përmbaruesi.

Nga mostrat e testuara kemi identifikuar se Komuna në vitin 2024 kishte paguar 1,074,473€, në emër të kamatave dhe procedurave përmbarimore,

si pasojë e pagesave me vendime gjyqësore. Në total, pagesat përfshirë borxhin dhe kamatat ishin 3,511,845€, ku për mallra dhe shërbime janë paguar 250,405€ dhe investime kapitale 3,261,440€.

Po ashtu, nga testimi i mostrave në tri (3) raste tek investimet kapitale me vlerë të përgjithshme prej 330,332€, dhe në tek mallra dhe shërbimet në nëntë (9) raste të testuara në vlerë totale prej 812,859€, kemi vërejtur se faturat ishin vonuar për pagesë, përtej afatit ligjor prej 30 ditësh. Vonesat në pagesë kanë qenë nga 12 deri në 316 ditë.

Kjo ka ndodhur për shkak të kontrolleve joadekuante në ekzekutimin e pagesave dhe menaxhim të kontratave publike, mungesës së fondeve financiare pasi disa kontrata janë lidhur pa fonde të mjaftueshme dhe vonesave në kompletim të lëndëve.

Ndikimi Vonesat në pagesën e faturave, dhe si rrjedhojë pagesat e realizuara përmes vendimeve gjyqësore, vështirësojnë realizimin e buxhetit sipas planifikimeve, si dhe shkaktojnë kosto shtesë në buxhetin e Komunës.

Rekomandimi B10 Kryetari duhet të forcojë kontrollet në menaxhimin e faturave, duke siguruar se pagesat bëhen brenda afatit të përcaktuar ligjor.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B11 - Subvencionimi i OJQ-ve pa thirrje publike

Gjetja Sipas nenit 2.1 të Rregullores MF-nr. 04/2017 - Mbi kriteret, standardet e financimit publik të Organizatave Jo Qeveritare (OJQ) parashihet që, financimi i projekteve dhe programeve të OJQ-ve bëhet sipas një thirrje publike, dhe të cilat i plotësojnë kriteret e Rregullores.

Komuna ka ndarë subvencion për Klubin Basketballistik "Sigal Prishtina" në vlerë prej 50,000€, pa shpallur thirrje publike dhe pa lidhur marrëveshje me përfituesin. Subvencioni është miratuar vetëm me vendim të Kuvendit Komunal.

Kjo kishte ndodhur për shkak të mosfunkcionimit të kontrolleve të brendshme dhe mungesës së përgjegjësisë për zbatimin e kërkesave ligjore lidhur me subvencionimin e OJQ-ve.

Ndikimi Ndarja e subvencioneve pa thirrje publike dëmton transparencën dhe konkurrencën, duke përashtuar OJQ-të e tjera nga mundësia për të aplikuar në mënyrë të barabartë. Për më tepër, mungesa e një marrëveshjeje të nënshkruar para pagesës rrezikon që përfituesi të mos jetë i obliguar ligjërisht për përbushjen e qëllimeve dhe kushteve të financimit, çka mund të ndikojë negativisht në menaxhimin e mjeteve publike.

Rekomandimi B11 Kryetari duhet të sigurojë se me rastin e mbështetjes financiare ndaj OJQ-ve, të aplikohen thirrjet publike sipas kërkesave të rregullores në fuqi. Gjithashtu, të sigurohet se nënshkrimi i marrëveshjes mes komunës dhe përfituesit, të bëhet para pagesës së mjeteve.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3 Çështjet tjera të menaxhimit finansiar dhe të pajtueshmërisë

2.3.1 Të hyrat

Të hyrat e realizuara nga Komuna e Prishtinës në 2024 ishin në vlerë 32,342,571€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, taksat për leje të ndërtimit, taksat administrative, të hyrat nga veprimtaritë biznesore, të hyrat nga taksat e legalizimit, taksat për mbeturina, të hyra nga taksat e infrastrukturës. Përveç të hyrave vetanake, komuna ka pranuar edhe të hyra indirekte të cilat grumbullohen nga niveli qendror në vlerë prej 4,624,345€ (gjobat në trafik 4,414,963€, të hyrat nga gjykata në vlerë prej 209,382€).

Çështja B12 - Vonesa në shqyrtimin e kërkesave për dhënien e lejeve të ndërtimit dhe lejeve mjedisore

Gjetja Sipas nenit 17, pika 1.2 të Ligjit nr. 04/L-110 për Ndërtim, leja ndërtimore duhet të lëshohet brenda 30 ditëve nga pranimi i kërkesës për kategorinë I dhe brenda 45 ditëve për kategoritë II dhe III.

Po ashtu, sipas nenit 11 të Udhëzimit Administrativ nr. 01/2017 për dhënien e lejeve mjedisore komunale, vendimi për miratim ose refuzim të lejes mjedisore komunale duhet të lëshohet brenda 30 ditëve nga data e pranimit të kërkesës, i nënshkruar nga drejtori i drejtorisë përkatëse.

Në 14 raste të testuara kemi vërejtur se Komuna nuk ka respektuar afatet ligjore për shqyrtimin e kërkesave për leje ndërtimore dhe mjedisore. Vonesat në shqyrtimin e lejeve ndërtimore shkonin deri në 22 muaj, ndërsa vonesat për lejet mjedisore deri në 6 muaj, përtej afateve të përcaktuara me legjislacion.

Këto vonesa kanë ndodhur si rezultat i mosfunkcionimit të kontrolleve të brendshme dhe mungesës së mbikëqyrjes.

Ndikimi Shqyrtimi i vonuar i kërkesave për leje ndikon negativisht në arkëtimin me vonesë të të hyrave që burojnë nga këto shërbime si dhe në mungesën e shërbimeve të rregullta dhe me kohë për qytetarët.

Rekomandimi B12 Kryetari duhet të analizojë shkaqet e vonesave të shqyrtimin e lejeve ndërtimore dhe atyre mjedisore, dhe të marrë masa që ato të shqyrtohen brenda afateve të përcaktuara ligjore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B13 - Shfrytëzimi i pronave publike pa kompensim dhe me kontrata të skaduara

Gjetja Ligji nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale përcakton se komunat kanë të drejtë të japid me qira pasurinë e luajtshme dhe të paluajtshme komunale, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

Gjatë vitit 2023, komisionet komunale të caktuara për verifikimin dhe vlerësimin e kontratave për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale kishin hartuar raporte dhe kishin dhënë rekomandime konkrete, përfshirë: lirimin e menjëhershëm të hapësirave të uzurpuara, dhënien në shfrytëzim të pronës komunale në përputhje me ligjet në fuqi për kontratat e

skaduara, pagesën retroaktive të rentës për tokën e shfrytëzuar, dhe lirimin e pronave të usurpuara nga shfrytëzuesit pa dokumentacion ligjor.

Në lidhje me këto rekomandime, Kuvendi Komunal kishte miratuar një rregullore për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale deri në 1 vit. Megjithatë, pas shqyrtimit të ligjshmërisë nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), rregullorja ishte kthyer për rishqyrtim.

Pavarësisht kësaj, Komuna nuk kishte ndërmarrë veprime të tjera konkrete për zbatimin e rekomandimeve as gjatë viti 2024.

Mungesa e kontrolleve të mjaftueshme dhe e monitorimit efektiv nga departamentet përkatëse kishte ndikuar që rekomandimet e komisioneve dhe të kuvendit të mos adresoheshin në kohë dhe në mënyrë të duhur.

Ndikimi	Moszbatimi i rekomandimeve dhe mungesa e veprimeve konkrete rrezikon që prona publike të vazhdojë të keqpërdoret nga shfrytëzuesit, ndërsa Komuna humb të hyrat që i takojnë, duke ndikuar negativisht në buxhetin lokal dhe në menaxhimin e qëndrueshëm të të hyrave.
Rekomandimi B13	Kryetari i Komunës duhet të sigurojë që rekomandimet e dhëna nga komisionet përkatëse dhe të miratuara nga Kuvendi Komunal të zbatohen brenda afateve të përcaktuara, në përputhje me legjisacionin në fuqi.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.2 Pagat dhe mëditjet

Buxheti final për paga dhe mëditje ishte 43,893,367€ derisa janë shpenzuar 43,879,580€, apo 99% e buxhetit. Numri i pozitave të aprovuara sipas ligjit të buxhetit ishte 4,871 punonjës, ndërsa në fund të viti numri i të punësuarve ishte 4,718.

Çështja A9 - Mungesa e dëshmive për vijueshmërinë në punë

Gjetja Neni 17 pika 1 e Rregullores (QRK) nr. 04/2024 për orarin e punës, pushimet dhe vijushmërinë e zyrtarëve publik përcakton “Zyrtari publik është i obliguar që të regjistrohet në regjistrin elektronik të vijueshmërisë”, dhe pika 3 “Kur nuk është e mundur për arsyte teknike, vijueshmëria në punë e zyrtarit publik bëhet përmes regjistrimit në librat evidetues”.

Nga mostrat e testuara gjatë auditimit për pagat dhe shtesat kemi evidentuar se:

- Në gjashtë (6) raste nuk ishte e mundur të sigurohen dëshmi për vijueshmërinë e zyrtarëve në punë, përmes sistemit elektronik apo librave evidetues.
- Po ashtu në katër (4) raste të kompensimeve për punë jashtë orarit, nuk ka pasur dëshmi për vijueshmërinë që vërteton kryerjen e punës jashtë orarit. Në një nga këto raste, është identifikuar një zyrtar që nuk ka figuruar fare në sistemin e hyrje/daljeve për muajin shtator 2024, ndërkohë që kishte një vendim për transfer tek një organizatë tjeter buxhetore të datës 01.09.2024. Pavarësisht kësaj, ka pranuar pagë të plotë për muajt shtator dhe tetor në vlerë 1,452€.

Sipas zyrtarëve të personelit, lënda për përpunim kishte arritur në zyrën për paga në nëntor 2024, pra me vonesë për dy muaj.

Këto kishin ndodhur pasi që Komuna nuk ka siguruar zbatim të plotë të sistemit të regjistrimit të vijueshmërisë për të gjithë zyrtarët publikë. Kjo mangësi vërehet kryesisht në nivelin e stafit drejtues dhe menaxherial. Për më tepër, janë të dobëta kontrolllet e brendshme lidhur me komunikimin dhe përpunimin në kohë të ndryshimeve në sistemin e pagave, si dhe mungon verifikimi sistematik i dokumentacionit mbështetës për pagesat shtesë.

Ndikimi Mungesa e regjistrimit të vijueshmërisë në sistemin elektronik apo evidencave alternative krijon rrezik që pagat të procesohen pa mbulesë faktike të punës. Po ashtu, pagesat për punë jashtë orarit pa dokumentacion mbështetës ndikojnë negativisht në efikasitetin financial, illogaridhënien dhe besueshmërinë e sistemit të menaxhimit të personelit dhe fondeve publike.

Rekomandimi A9 Kryetari duhet të sigurojë funksionalizimin e plotë të regjistrimit elektronik të vijueshmërisë për të gjithë zyrtarët, pa përashtime, dhe të ndërmerren masa për verifikim të rregullt dhe të pavarur të evidencave të pranisë në punë. Po ashtu, duhet të forcohen kontrolllet e brendshme në departamentin e pagave, në mënyrë që çdo ndryshim në statusin e zyrtarëve të reflektohet në kohë reale, dhe pagat të procesohen vetëm për periudhën kur ekziston angazhim i ligjshëm dhe dokumentuar. Në rastet kur janë bërë pagesa të pajustifikuara, duhet të vendoset mënyra konkrete e kthimit të tyre në buxhetin e Komunës.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A10 - Mos azhurnimi i kontratave të punës në bazë të ligjit për zyrtarët publik

Gjetja

Neni 34 i Rregullores (QRK) nr. 06/2024 për klasifikimin e vendeve të punës në shërbimin civil përcakton "Obligojen institucionet në fushën e veprimit të kësaj Rregulloreje të përgatisin klasifikimin dhe grupimin e pozitave të punës në pajtim me këtë Rregullore dhe katalogun e vendeve të punës, jo më vonë se tre (3) muaj nga hyrja në fuqi e kësaj Rregulloreje". Po ashtu neni 102 pika i Ligjit nr. 08/I-197 për zyrtarët publik përcakton "Me hyrje në fuqi të këtij ligji, obligohen të gjitha institucionet që të përgatisin dhe t'ju ofrojnë zyrtareve/ëve aktual për nënshkrim aktet e reja të emërimit dhe/apo kontratat e punës".

Gjatë auditimit kemi vërejtur se Komuna ende nuk e kishte hartuar rregulloren për sistematizimin dhe klasifikimin e vendeve të punës, si parakusht për harmonizimin e kontratave të punës me kuadrin e ri ligjor. Nga 70 kontrata të testuara, në 46 raste kontratat nuk ishin të azhurnuara sa i përket koeficienteve dhe elementeve tjera të përcaktuara me Ligjin për zyrtarët publik.

Si rrjedhojë, zyrtarët publikë vazhdojnë të kenë kontrata të pa harmonizuara me ligjin dhe rregulloret në fuqi. Sipas informacioneve të marra nga zyrtarët kompetentë, është krijuar komisioni për hartimin e rregullores, dhe dokumenti është në fazën e finalizimit.

Mos azhurnimi i kontratave ka ardhur si rezultat i mos hartimit me kohë të rregullores për sistematizimin dhe klasifikimin e vendeve të punës, e cila është një kusht paraprak për zbatimin e Ligjit për Zyrtarët Publik në aspektin e kontratave dhe koeficienteve të ri.

Ndikimi

Mos azhurnimi i kontratave të punës dhe mospërputhja me sistemin e ri të koeficienteve ka shkaktuar mosrespektim të kërkesave ligjore dhe ka ndikuar në mos përfshirjen e saktë të pozitave në strukturën e pagave.

Rekomandimi A10

Kryetari duhet të përshpejtojë finalizimin dhe miratimin e rregullores për sistematizimin dhe klasifikimin e vendeve të punës, në mënyrë që të mundësohet azhurnimi i kontratave të punës në përputhje me Ligjin për Zyrtarët Publik.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.3 Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë

Buxheti final për mallra dhe shërbime ishte 32,884,446€, derisa janë shpenzuar 32,726,680€ apo rrëth 99% e buxhetit. Ato kryesisht kanë të bëjnë me shpenzime të projektimeve dhe konsulencës, riparimit dhe mirëmbajtjes, blerjen e pajisjeve, shpenzimeve të transportit, etj.

Çështja A11 - Dobësi në menaxhimin e projekteve përmes platformës elektronike të e-prokurimit

Gjetja	Neni 70.24 pika (f) e Rregullorës nr. 001/2022 për prokurimin publik, parashev se menaxherët e kontratës "Të sigurojnë që të gjitha regjistrat e menaxhimit të kontratës të përgatiten, mbahen dhe arkivoohen në modulin për menaxhim të kontratës në sistem të prokurimit elektronik". Nga testimet e bëra ka rezultuar se në tetë (8) ⁸ raste menaxhimi i kontratave dhe vlerësimi i perfomancës së kontraktuesve nuk është mbajt përmes sistemit elektronik të e-prokurimit. Mospërdorimi i sistemit ka ndodhur si rezultat i anashkalimit të procedurës së përcaktuar nga rregullorja, për shkak të mungesës së përgjegjësisë administrative nga ana e zyrtarëve përgjegjës për menaxhimin e kontratave.
Ndikimi	Mos mbajtja e kontratave përmes sistemit elektronik të e-prokurimit mund të aplikoj në menaxhim jo të mirë të kontratave dhe nuk ofron mundësi të mjaftueshme që menaxhmenti apo përdoruesit të tjerë të lejuar të marrin informata me kohë reale në lidhje me progresin dhe menaxhimin e perfomancës të kontratave.
Rekomandimi A11	Kryetari duhet të sigurojë që të gjitha kontratat të menaxhohen dhe dokumentohen përmes modulit për menaxhimin e kontratës në sistemin e e-prokurimit në pajtim me kërkesat ligjore. Gjithashtu, të ndërmerren masa për forcimin e disiplinës administrative dhe monitorimit të brendshëm, në mënyrë që zyrtarët përgjegjës të përmbushin detyrimet që dalin nga legjislacioni në fuqi.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.4 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera e paraqitur në PFV e pasurive kapitale është 2,551,789,039€, pasurive jokapitale është 3,423,170€, si dhe e stoqeve 1,218,304€.

Çështja B14 - Dobësi në inventarizimin e pasurisë dhe pasqyrimin e pasurisë nën 1,000€ dhe stoqeve

Gjetja Neni 19 paragrafi 4.3 i rregullores Nr. 02/2013 - për Menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore, përcakton se: Përgjegjësi e Komisionit për Inventarizimin e Pasurive jo Financiare është edhe "Krahasimi i gjendjes të inventarizuar me gjendjen në regjistrat e pasurive jo financiare".

Ndërsa, sipas nenit 24, pas barazimit të gjendjes me inventarizim dhe vlerësim me gjendjen e regjistrave të pasurirë jo financiare, gjendja e pasurisë jo financiare duhet të jetë pjesë e pasqyrave vjetore financiare në pajtim me Rregullën financiare për pasqyrat vjetore financiare.

Sipas nenit 6, pika 3 të kësaj rregulloreje, pasuritë jokapitale dhe stoqet duhet te registrohen dhe menaxhohen nga program e-pasuria.

Gjatë auditimit lidhur me menaxhimin e pasurisë kemi vërejtur mangësitë si në vijim:

- Komuna ka realizuar procesin e inventarizimit në disa drejtori përkatëse, mirëpo ky proces nuk është kryer në Drejtorinë e kulturës, sportit dhe shërbimeve publike. Për më tepër, nuk është përgatitur një raport përbledhës i inventarizimit që do të mundësonte krahasimin dhe harmonizimin e gjendjes me regjistrat ekzistues të pasurive, siç kërkohet me nenin 19 dhe 24 të rregullores.
- Gjithashtu, pasuritë me vlerë nën 1,000€ dhe stoqet nuk janë raportuar as këtë vit në pasqyrat financiare përmes sistemit e-pasuria, pavarësisht krijimit të një komisioni për regjistrim dhe përfundimit të punës së tij në dhjetor 2024. Regjistrimi i pasurive është bërë në sistem, por raportimi financiar është bazuar në regjistrat manualë (Excel), të cilët mirëmbahen nga zyrtari i pasurisë.

Sipas këtij të fundit, raportimi përmes e-pasurisë nuk ka qenë i mundur për shkak të mungesës së të dhënavë të vlerësuara nga disa drejtori nga komisioni përkatës, si dhe mungesës së futjes të dhënavë në sistem pëblerjet e vitit 2024; dhe

- Nga një pagesë në vlerë prej 24,482€, vetëm 14,841€ janë evidentuar në regjistrat në excel si pasuri nën 1,000€. Ndërsa shuma prej 9,641€, e cila i përket materialit shpenzues të dërguar në Drejtorinë e Arsimit, nuk është regjistruar fare në regjistrin e stoqeve.

Këto mangësi janë rezultat i mungesës së koordinimit ndërmjet drejtorive dhe zyrtarëve përgjegjës për pasuri, si dhe mungesës së një qasjeje të përbashkët për menaxhimin e pasurive.

Po ashtu, mos përfshirja e disa njësive në procesin e inventarizimit tregon për mungesë të përgjegjësisë në zbatimin e kërkeseve ligjore.

Ndikimi Mos përfshirja e të gjitha njësive organizative në procesin e inventarizimit dhe mungesa e një raporti përbledhës rrezikon saktësinë dhe tërësinë e të dhënavë për pasuri në pasqyrat vjetore financiare.

Mos regjistrimi i plotë në sistemin e-pasuria dobëson kontrollin dhe menaxhimin efektiv të pasurive jokapitale, ndërsa përdorimi i regjistrave manualë rrit rrezikun për gabime, mospërputhje dhe mungesë transparence.

Rekomandimi B14 Kryetari duhet të sigurojë që procesi i inventarizimit të përfshijë të gjitha njësítë organizative dhe të hartohet një raport përbledhës që reflekton gjendjen reale të pasurisë. Gjithashtu, duhet të ndërmerren veprime konkrete për të forcuar bashkëpunimin ndërmjet drejtiveve dhe zyrtarëve përkatës, si dhe të sigurohet që të gjitha pasuritë jokapitale dhe stoqet të regjistrohen dhe raportohen përmes sistemit e-pasuria, në përputhje me kërkesat ligjore dhe rregulloret në fuqi.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.5 Të arkëtueshmet

Komuna e Prishtinës në PFV-të e vitit 2024 ka shpalosur llogari të arketueshme në vlerë prej 85,693,408€. Kjo vlerë kryesisht përbëhet prej tatimit në pronë në vlerë 49,214,027€, taksa nga mbeturinat në vlerë 14,828,952€, taksave nga leje ndërtimi në vlerë 11,494,887€, taksat të tjera në vlerë 10,155,542. Gjatë vitit 2024, llogaritë e arkëtueshme nga tatimi në pronë janë rritur për 8,925,184€ ose 22% krahasuar me vitin 2023.

Çështja C1 - Mosarkëtimi i borxheve nga taksat për mbeturina

Gjetja	Sipas nenit 18, pika 1 të Rregullores për Menaxhimin e Mbeturinave të Komunës së Prishtinës, të datës 01.12.2023, në rast se një debitor nuk kryen pagesën e tarifës për mbeturina, Komuna ka të drejtë të ndërmarrë veprime ligjore përmes procedurës gjyqësore në gjykatën kompetente ose përmes përbartuesve privat, me qëllim të mbledhjes së borxheve të pambledhura.
	Llogaritë e arkëtueshme për vitin 2024 ishin gjithsej 85,693,408€, prej të cilave 14,828,951€ apo 17% ishin për taksat e pa mbledhura nga mbeturinat. Komuna përgjatë vitit 2024 nuk kishte ndërmarrë asnje veprim konkret për mbledhjen e këtyre borxheve gjatë vitit, siç parashihet me rregullore.
	Kjo situatë ka ardhur si rezultat i mospërfsirjes aktive të departamentit përgjegjës në ndërmarrjen e veprimeve të nevojshme për arkëtimin e borxheve, si dhe mungesës së një mekanizmi të qartë monitorues për debitorët.
Ndikimi	Mosinkasimi i të hyrave nga tarifat për mbeturina zvogëlon kapacitetin e Komunës për të realizuar të hyrat vetanake, duke ndikuar negativisht në buxhetin komunal dhe realizimin e projekteve të financaura nga këto fonde.
Rekomandimi C1	Kryetari duhet të sigurojë forcimin e mekanizmave të kontrollit dhe veprimit në procesin e arkëtimit të borxheve, duke shfrytëzuar të gjitha mjetet ligjore në dispozicion, përfshirë procedurat përbartimore dhe ato gjyqësore, me qëllim të rritjes së efikasitetit në menaxhimin e të hyrave vetanake.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.6 Funksioni i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) në Komunën e Prishtinës operon me pesë anëtarë të stafit - Drejtor i NjAB dhe katër auditorë. Për vitin 2024, kjo njësi kishte hartuar planin vjetor të punës bazuar në planin strategjik ku kishte planifikuar 8 auditime të rregullta dhe një me kërkësë, prej të cilave ishin finalizuar të gjitha auditimet e rregullta të cilat kishin të bënin me procedurat e menaxhimit të prokurimit në Komunë, ekskursionet, inspektionet, menaxhimin e pajisjeve mjekësore, ekzekutimin e buxhetit në drejtorinë e arsimit dhe drejtorinë e investimeve kapitale dhe menaxhimit të kontratave, autoparkun, menaxhimin e subvencioneve në drejtorinë e bujqësisë. Në këto raporte janë dhënë gjithsej 42 rekomandime. Prej tyre 22 ishin zbatuar, 12 ishin në proces dhe 8 të pazbatuara. Periudha e mbuluar në raportet e NjAB kryesisht përfshinte vitin e kaluar deri në kohën e përfundimit të auditimit përkatës. Komiteti i Auditimit kishte mbajtur gjashtë takime përgjatë vitit 2024 ku janë përpiluar edhe procesverbale ku kishte shqyrtuar raportet, gjetjet e NjAB, rekomandimet dhe progresin e tyre.

Çështja A12 - Mungesë e planeve të veprimit dhe mangësi në procesin e verifikimit të zbatimit të rekomandimeve

Gjetja Sipas nenit 23 pika 1.3 të Ligjit nr. 06/021 për kontrollin e brendshëm të financave publike, Udhëheqësi i subjektit të sektorit publik siguron zbatimin e rekomandimeve të pajtura për auditimin e brendshëm.

Ndërsa, sipas nenit 9 pika 7 të Rregullores QRK nr. 01/2019 për themelimin dhe zbatimin e funksionit të auditimit të brendshëm në subjektin e sektorit publik, Auditorët e brendshëm monitorojnë zbatimin e rekomandimeve në mënyrë sistematike sipas planit të veprimit të miratuar nga udhëheqësi i subjektit të sektorit publik.

Nga tetë (8) raporte të auditimit të brendshëm, vetëm pesë drejtori kanë përgatitur planet e veprimit për adresim të rekomandimeve. NjAB në raportet e auditimit të brendshëm kishte dhënë 42 rekomandime, dhe nga to ishin zbatuar vetëm 22, ndërsa tetë (8) rekomandime nuk ishin adresuar fare dhe 12 të tjera ishin në proces të zbatimit.

Mungesa e planeve të veprimit ka ndikuar në vështirësi për përcjelljen e zbatimit të rekomandimeve dhe ka krijuar pengesa gjatë përgatitjes së raportit vjetor të Njësisë për Koordinim dhe Harmonizim të Auditimit të Brendshëm (NJQHAB).

Gjithashtu, nuk është e qartë se si NjAB ka përcjellë procesin e implementimit të rekomandimeve, pasi për të dhënat e raportuara lidhur me numrin e rekomandimeve të zbatuara nuk kemi mundur të bëjmë verifikimin real të tyre. Kjo krijon paqartësi lidhur me raportimin e progresit dhe tregon nevojën për një mekanizëm më të qartë dhe të dokumentuar të monitorimit dhe raportimit të zbatimit të rekomandimeve të auditimit të brendshëm.

Këto mangësi janë rezultat i mungesës së përkushtimit nga ana e menaxhmentit dhe njësive të audituara për të adresuar dhe përmirësuar funksionimin e kontrollit të brendshëm.

Mospërdorimi i një mekanizmi të dokumentuar për monitorimin e zbatimit të rekomandimeve, ka ndikuar që të mos ketë pasqyrë të saktë dhe të verifikueshme mbi progresin e zbatimit të rekomandimeve.

Ndikimi Çështjet e theksuara më lartë mund të cenojnë besueshmërinë e sistemit të

kontrollit të brendshëm, e kufizojnë mundësinë për të vlerësuar efektivitetin e masave të ndërmarra nga menaxhmenti, dhe pamundësojnë marrjen e vendimeve të informuara për përmirësimin e proceseve. Kjo gjithashtu rrezikon që të përsëriten dobësi të njëjta nga viti në vit.

- Rekomandimi A12** Kryetari duhet të sigurojë që të gjitha drejtoreti e audituara të përgatisin dhe dorëzojnë planet e veprimit pér adresimin e rekomandimeve të NjAB-së, në përputhje me udhëzimet përkatëse. Ndërsa, NjAB duhet të zhvillojë dhe zbatojë një procedurë të qartë dhe të dokumentuar pér ndjekjen dhe raportimin e progresit të rekomandimeve të dhëna, duke u bazuar në informata të verifikueshme.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përbledhur për burimet e fondevet buxhetore, shpenzimin e fondevet dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondevet buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestare	Buxheti final ⁹	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet
Burimet e fondevet	123,699,998	171,772,332	138,197,295	114,195,436	87,375,438
Grante Qeveritare - Buxheti	83,921,030	87,152,973	84,136,708	70,033,925	58,872,924
Financimi përmes huamarrjes	0	0	0	0	624,289
Financimi përmes huamarrjes - klauzola e investimeve	1,000,000	1,000,000	969,980	0	0
Të bartura nga viti i kaluar	0	44,770,569	30,405,135	25,056,184	16,043,271
Të hyrat vetanake	38,778,968	38,778,968	22,671,402	19,105,328	11,831,886
Donacionet vendore	0	34,554	0	0	1,500
Donacionet e jashtme	0	35,268	14,070	0	1,567

Buxheti final i Komunës së Prishtinës është më i lartë se buxheti fillestare për 48,072,334€ apo 39%. Kjo rritje e buxhetit është rezultat i vendimeve të Qeverisë për ndarje buxhetore në vlerë prej 3,231,942€, përfshirjes së të hyrave të bartura nga vitet paraprak në vlerë prej 44,770,569€ dhe donacioneve në vlerë prej 69,822€ në buxhet final.

Në vitin 2024, Komuna ka shpenzuar 80.4% të buxhetit final ose 138,197,295€, me një rritje prej 12.2% në raport me vitin e kaluar. Sidoqoftë, shpjegimet për pozicionin aktual janë detajuar më poshtë.

Vlen të theksohet së Thesari nga kategori të ndyshme ekonomike sipas vendimeve përbirimore/gjyqësore kishte realizuar pagesa në vlerë 10,582,839€, për obligime të dala nga kontrata kolektive pjesa për shpronësime dhe për operatorë ekonomik.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)


Përshkrimi	Buxheti filletar	Buxheti final	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	123,699,998	171,772,332	138,197,295	114,195,436	87,375,438
Pagat dhe mëditjet	40,499,674	43,893,367	43,879,580	39,574,435	32,700,638
Mallrat dhe shërbimet	28,200,000	29,883,101	29,833,925	29,344,958	26,396,100
Komunalitë	3,000,000	3,001,345	2,892,755	2,607,669	2,517,257
Subvencionet dhe transferet	5,500,000	5,747,022	5,232,457	5,143,898	7,396,124
Investimet Kapitale	46,350,325	89,247,497	56,358,577	37,524,476	18,365,319
Rezervat	150,000	0	0	0	0

Komuna kishte lëvizje buxhetore nëpër kategori. Megjithatë, të gjitha lëvizjet/ndryshimet ishin të mbështetura me vendime përkatëse të Ministrisë së Financave dhe Qeverisë. Sqarimet rreth ndryshimeve buxhetore janë shpalosur si në vijim:

- Buxheti final për paga dhe mëditje në krahasim me buxhetin filletar ishte rritur për 3,393,693€. Buxheti final përbehet nga granti qeveritar në vlerë prej 43,731,616€, pastaj nga të hyrat vetanake të bartura prej 150,000€ dhe donacionet e jashtme prej 11,751€. Për peridhën janar - dhjetor 2024 realizimi i buxhetit është 99.9%;
- Buxheti final për mallra dhe shërbime në krahasim me buxhetin filletar ishte rritur për 1,683,101€. Pjesa më e madhe e këtij buxhetit përbëhet nga granti qeveritar prej 22,862,000€, të hyrave vetanake prej 5,338,000€, të hyrave të bartura prej 1,676,132€ dhe donacionet në vlerë prej 6,969€; Deri në fund të vitit 2024 realizimi i buxhetit ishte 99.8%;
- Buxheti final për shpenzime komunale në krahasim me buxhetin filletar kishte rritje për 1,345€ nga të hyrat vetanake të bartura prej 1,345€. Deri në fund të vitit realizimi i buxhetit ishte 96.4%;
- Buxheti final për subvencione dhe transfere në krahasim me buxhetin filletar kishte rritje për 247,022€. Ky buxhet përbëhet nga fondi qeveritar prej 3,000,000€, të hyrave vetanake prej 2,500,000€, të hyrave vetanake për bartje prej 213,114€ dhe grantit të donacioneve të brendshme prej 33,908€. Realizimi i buxhetit në fund të vitit ishte 91%;
- Buxheti final për investime kapitale në krahasim me buxhetin filletar kishte rritje në vlerë prej 42,897,172€. Ky buxhet përbehet nga fondi i huamarrjes në vlerë prej 1,000,000€, fondi qeveritar prej 14,559,357€, të hyrave vetanake prej 30,940,968€, të hyrave vetanake për bartje prej 42,729,978€ dhe donacioneve prej 17,194€. Deri në fund të vitit Komuna kishte arritur të shpenzoj vetëm 56,358,577€ apo 63.1%. Nga kjo vlerë, vetem në muajin dhjetor janë realizuar pagesa në vlerë 19,784,921€ apo 35%.

Ky nën realizim i buxhetit fillimi shtron vjen si pasojë e nënshkrimit të kontratave në periudhën e katërt të tremujorit të vitit, ndërkohë që edhe kontratat e nënshkruara gjatë vitit 2024 kishin hasur pengesa në realizim në raport me planin dinamik qysh në fillim për shkak të mos plotësimit të kushteve për fillim të punimeve, sikurse mos pajisja me leje të nevojshme, problemet me shpronësimet, punë të paplanifikuar si rezultat i mos hartimit të mirë të projekteve, etj.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2024



Të hyrat e realizuara nga Komuna e Prishtinës në 2024 ishin në vlerë 32,342,571€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, taksat për leje të ndërtimit, taksat administrative, të hyrat nga veprimtaritë biznesore, të hyrat nga taksat e legalizimit, taksat për mbeturina, të hyrta nga taksat e infrastrukturës. Për vitin 2024, Komuna kishte planifikuar të hyra në vlerë prej 38,778,968€. Në krahasim me vitin e kaluar niveli i inkasimit të të hyrave ka shënuar zvogëlim prej 2,385,633€. Rritja në inkasimin e të hyrave gjatë vitit ka pasur tek të hyrat e tatimit në pronë prej 6.16%.

Përveç kësaj shume, të hyrat nga gjobat në trafik dhe gjobat nga Gjykatat ishin në shumën prej 4,624,421€ të cilat grumbullohen nga Ministria e Punëve të Brendshme (MPB) dhe Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK) të cilat i alokohen Komunës për shpenzim. Këto të hyra nuk janë të përfshira në tabelën e më poshtme, për arsy se këto i planifikojnë dhe realizojnë ministritë e linjës.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2024 Pranimet	2023 Pranimet	2022 Pranimet
Totali i të hyrave	38,778,968	38,778,968	32,342,571	34,728,204	31,576,156
Të hyrat tatimore	14,905,828	14,905,828	8,618,214	13,133,087	9,161,332
Të hyrat jo tatimore	23,873,140	23,873,140	23,708,938	21,587,700	22,396,975
Të hyrat tjera	0	0	15,419	7,417	17,848

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2023 të Komunës së Prishtinës ka rezultuar në 22 rekomandime kryesore. Komuna kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2024, tetë (8) rekomandime janë zbatuar; një (1) ishte në proces dhe për 13 rekomandime nuk ka filluar zbatimi ende, siç është paraqitur në Grafikun 2, më poshtë.

Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 3 (ose Tabelën e rekomandimeve).

Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4. Përbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2023	Veprimet e ndërmarrা	Statusi
1.	Baza pér opinion	Kryetari duhet të sigurojë kontolle efektive në regjistrimin dhe paraqitjen e saktë të vlerës së detyrimeve të papaguara, sipas kërkesës së rregullores për raportim finansiar, në mënyrë që të mundësohet raportim i saktë i tyre në PVF.	Këtë vit nuk kemi hasur në mos raportim të saktë të obligimeve të papaguara në PVF.	I zbatuar
2.	Baza pér opinion	Kryetari duhet të sigurojë që pasuritë kapitale regjistrohen dhe raportohen në mënyrë të saktë dhe të plotë, në përputhje me kërkesat ligjore.	Gjatë auditimit të pasurisë nuk kemi hasur në raste ku pasuria nuk ka qenë e regjistruar në SIMFK.	I zbatuar

3.	Baza për opinion	Kryetari duhet të sigurojë forcimin e kontolleve dhe mbikqyrjen, veçanërisht në rastet kur kemi një volum të madh të lëndëve, në menaxhimin e detyrimeve kontingjente, në mënyrë që informatat financiare për detyrimet kontingjente të shpalosen në mënyrë të saktë dhe të plotë.	Rekomandimi nuk është adresuar, pasi që edhe këtë vit kemi hasur në nënvlërësimin e detyrimeve kontingjente ne PVF.	Nuk ka filluar zbatimi
4.	Baza për konkluzion	Kryetari i Komunës, duhet të forcojë llogaridhëni lidhur me menaxhimin e projekteve kapitale, duke siguruar se për cdo ndryshim në termat dhe kushtet e kontratës, të zbatohen procedurat përmarrjen e aprovimeve të duhura sipas rregullave të prokurimit/aplikueshme dhe amandamentimin e kontratës në pajtim me ndryshimet e bëra.	Rekomandimi nuk ishte zbatuar pasi që edhe këtë vit kemi hasur në raste ku janë ndryshuar pozicionet e kontratës pa aprovimet e duhura.	Nuk ka filluar zbatimi
5.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë forcimin e kontolleve në fushën e dhënieve dhe monitorimit të subvencioneve, në mënyrë që fonde e dhëna nga komuna të shfrytëzohen vetëm për qëllimet e subvencionuara. Nëse përfituesit nuk arrijnë të arsyetojnë shfrytëzimin e fondeve në përputhje me qëllimin e dhënë, të merren masa përkthimin e fondeve nga përfituesit.	Gjatë auditimit nuk kemi hasur në raste të tillë.	I zbatuar
6.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë, se për çdo ndryshim në shumat buxhetore të projekteve të aprovuara në ligjin e buxhetit, të marrë paraprakisht aprovimin nga Kuvendi Komunal.	Edhe këtë vit Komuna kishte bërë pagesa në mungesë të aprovimit nga Kuvendi komunal nga shumat buxhetore të projekteve të tjera kapitale.	Nuk ka filluar zbatimi
7.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë se respektohen hapat e përcaktuar me rregullat në fuqi për procedimin e pagesave nga zyrtarët përgjegjës, në mënyrë që fillimisht të bëhet zotimi i mjeteve, të nxjerret urdhërblerja dhe më pas pranimi i mallrave/punëve.	Edhe këtë vit kemi hasur në raste ku urdhërblerja dhe zotimi janë procesuar pas pranimit të faturës.	Nuk ka filluar zbatimi

8.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë forcimin e kontolleve në fushën e prokurimit, në mënyrë që vlerësimi i ofertave të bëhet në pajtueshmëri të plotë me kërkesat e vendosura në dosjet e tenderit dhe në pajtueshmëri me kërkesat ligjore. Po ashtu, përmes zyrtarëve përgjegjës të sigurojë se anëtarët e komisioneve i kuptojnë detyrat dhe përgjegjësitë e tyre në angazhimet përkatëse, dhe në rast të gabimeve eventuale këto të evidentohen nga zyrtarët e prokurimit para nënshkrimit të raportit të vlerësimit.	Edhe këtë vit kemi hasur në mangësi në procesin e vlerësimit të ofertave ku si pasojë janë përzgjedhur fitues OE të cilet nuk i plotësojne kriteret sipas dosjes së tenderit.	Nuk ka filluar zbatimi
9.	Pasqyrat Financiare Vjetore	Kryetari duhet të sigurojë se shpenzimet planifikohen dhe realizohen sipas kategorive ekonomike adekuate, në përputhje me planin kontabël, për të mundësuar raportimin e drejtë të tyre në PVF.	Nuk janë ndërmarrë veprime për të klasifikuar drejtë shpenzimet nga kodet jo adekuate.	Nuk ka filluar zbatimi
10.	Të hyrat	Kryetari duhet të sigurojë bashkëpunim dhe komunikim më të mirë ndërmjet Departamentit të Tatimit në Pronë Komunal dhe MFPT-së, në mënyrë që të eliminohen gabimet e mundshme në të dhënat për tatimin e vlerësuar, apo ndonjë gabim tjetër eventual.	Nga mostrat e testuara nuk kemi hasur mangësi në aplikimin e zbritjes përvendbanimet parësore.	I zbatuar
11.	Të hyrat	Kryetari duhet të analizojë shkaqet e vonesave të shqyrtimin e lejeve ndërtimore dhe atyre mjedisore, dhe të marrë masa që ato të shqyrtohen brenda afateve të përcaktuara ligjore.	Nuk janë ndërmarrë veprime në këtë drejtim.	Nuk ka filluar zbatimi
12.	Të hyrat	Kryetari duhet të sigurojë që rekomandimet e dhëna nga komisionet përkatëse, të aprovuara nga kuvendi komunal, të zbatohen sipas kërkesave të përcaktuara në afat sa më të shpejtë.	Përgjatë vitit 2024 nuk ishin ndërmarrë masa efektive përvendbanimet e kërkesave nga komisionet përkatëse.	Nuk ka filluar zbatimi
13.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Kryetari duhet të sigurojë se kontrata lidhen në kohën e duhur, faturimi dhe pranimi i punëve si dhe pagesa për këto punë të bëhen sipas çmimeve të kontraktuara për periudhën përkatëse dhe jo në mënyrë retroaktive.	Gjatë testimeve nuk kemi hasur në raste të tillë.	I zbatuar
14.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Kryetari duhet të sigurojë forcimin e kontolleve në Departamentin e Prokurimit dhe Drejtoren e Financave përtu siguruar se janë zhvilluar procedurat e prokurimit me kohë përlidhjen e kontratës për shërbimet e sigurimit ne mënyrë që shmanget situatat e porosive jashtë afatit të kontratës që bien ndesh me ligjin.	Gjatë testimeve nuk kemi hasur në raste të tillë.	I zbatuar

15.	Subvencionet dhe transferet	Kryetari duhet të sigurojë se me rastin e mbështetjes financiare ndaj OJQ-ve, të aplikohen thirrjet publike sipas kërkesave të rregullores në fuqi. Gjithashtu, të sigurohet se nënshkrimi i marrëveshjes mes komunës dhe përfituesit, të bëhet para pagesës së mjeteve.	Komuna edhe këtë vit kishte ndarë subvencione ndaj OJQ-ve pa aplikuar thirrjen publike.	Nuk ka filluar zbatimi
16.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë se para iniciimit të projekteve për punë, të përmbytjen kushtet e realizimit projektit siç janë, pajisja me lejet e nevojshme për punë, zgjidhja e çështjeve pronësore, hartimi i mirëfilltë i projekteve ekzekutuese për t'u minimizuar kërkesat për punë të pa parapara, si dhe të forcohen kontrolllet në mbikëqyrjen e vazhdueshme të progresit të projekteve, në mënyrë që punët të realizohen sipas planeve dinamike dhe sigurimet e ekzekutimit të ofruara nga operatorët ekonomik të mbulojnë periudhën deri në 30 ditë pas kompletimit të kontratës.	Nuk janë ndërmarrë veprime për të siguruar realizimin e projekteve kapitale sipas planit dinamik.	Nuk ka filluar zbatimi
17.	Investimet kapitale	Kryetari i Komunës duhet të sigurojë përmes njësive kërkuese, që gjatë përgatitjes së kërkesave dhe dosjeve të tenderit për kontratat publike kornizë sipas peshimit, të luaj një rol aktiv në përcaktimin e nevojave reale të komunës, në mënyrë që këto kontrata të realizohen në pajtueshmëri të plotë me peshët e përcaktuara në dosjen e tenderit.	Janë hasur sërisht raste të tejkalimit të sasive në kontratat publike kornizë me çmime për njësi.	Nuk ka filluar zbatimi
18.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë se pozicionet të cilat janë paguar dhe nuk janë përfunduar, të finalizohen në pajtim me kontratën, poashtu të sigurohet se cilësia e punëve të realizuara është në pajtim me kushtet kontraktuale dhe se punët e démtuara janë rregulluar në pajtim me kushtet e kontratës.	Gjatë audutimit nuk kemi hasur në raste të tillë.	I zbatuar
19.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë rritjen e përgjegjësisë tek njësitë kërkuese lidhur me përgatitjen e specifikave për kontratat për punë, duke siguruar që ato të janë në përputhje me projektin ekzekutues, si dhe të ndërmarrë veprime për të parandaluar rreziqet e pagesave të dyfishta për punë të njëjta lidhur me projektet kapitale.	Nga testet audituese dhe verifikimet në teren nuk kemi vërejtur raste të tillë.	I zbatuar
20.	Çështjet e përbashkëta	Kryetari duhet të forcojë kontrolllet në menaxhimin e faturave, duke siguruar se pagesat bëhen brenda afatit të përcaktuar ligjor.	Edhe kete vit janë hasur pagesa përvendime gjyqësore dhe vonesa në kryerjen e obligimeve.	Nuk ka filluar zbatimi

21.	Pasuritë	Kryetari duhet të sigurojë se pasuritë jokapitale dhe stoqet të regjistrohen dhe menaxhohen përmes sistemit e-pasuria. Të ndërmerrën veprimet e nevojshme në futjen në përdorim të këtij aplikacioni për menaxhimin e pasurisë. Inventarizimi i pasurisë të kryhet para përfundimit të vitit fiskal, me qëllim që të gjitha ndryshimet në vlerën e pasurisë të reflektojnë në raportin vjetor financier.	Rekomandimi nuk është zbatuar pasi raportimi i pasurisë nën 1,000€ dhe stoqeve për vitin 2024 është bërë përmes regjistrave excel e jo sistemit E-pasuria. Poashtu nuk është kryer inventarizimi në të gjitha drejtoreti, dhe komisioni i inventarizimit nuk ka hartuar raport përbledhës për procesin e inventarizimit.	Nuk ka filluar zbatimi
22.	Llogaritë e arkëtueshme	Kryetari duhet të sigurojë forcimin e mekanizmave të kontrollit në mbledhjen e borxheve nga tatimpaguesit, duke i shfrytëzuar të gjitha mjetet në dispozicion, pa përjashtuar edhe veprimet ligjore.	Gjatë rishikimit kemi vërejtur se Drejtoria e tatimit në pronë dhe urbanizmit kishte ndërmarrë masa për adresimin e rekomandimit, përderisa ishin ndërmarrë masa efektive për arkëtimin e borxheve nga tatimpaguesit tek taksat për mbeturinat.	Pjesërisht i zbatuar

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Blerim Kabashi, Drejtor i Auditimit



Nora Rashiti Nishefci, Udhëheqëse e ekipeve



Kushtrim Leci, Anëtar i ekipeve



Ajtene Llapashtica, Anëtare e ekipeve



Endrita Gjyrevci, Anëtare e ekipeve



Shtojca I: Letër konfirmimi

<p>REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIQUE DE KOSOVO KOMUNA E PRISHTINËS OPŠTINA PRISTINA</p> <p>02 -06- 2025 M. 030101- 76983/25 NR. BR.</p>		
	<p>Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo Komuna e Prishtinës Opština Priština –Municipality of Prishtina</p>	
<p>LETËR E KONFIRMIMIT</p> <p>Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2024 dhe përzbatimin e rekomandimeve</p>		
<p>Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit</p>		
<p>Të nderuar,</p>		
<p>Përmes kësaj shkresë, konfirmoj se:</p>		
<ul style="list-style-type: none">kam pranuar draft reportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Komunës së Prishtinës, për vitin 2024 (në tekstin e mëtejmë “Reporti”);pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përbajtjen e Reportit; si dhebrenda 30 ditëve nga pranimi i Reportit final, do t’ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.		
<p>Përparim Rama</p>		
<p>Kryetar i Kryeqytetit</p>		
		
		
<p>Data: 29.05.2025</p>		

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare¹⁰ duhet të përbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet¹¹, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financier në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opioni i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tëresi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangje të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tëresi nuk përbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë opinion të pa-modifikuar nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në reportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në reportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit pér të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opioni i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinioni

Opioni i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit pér pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur pér këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shhangje të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opioni i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit pér pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur pér këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, pér të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen pér shkak të pamundësisë pér të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financave;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në reportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në reportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Parografi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinioni i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo reportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo parografi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkuption çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkuption çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C - nënkuption çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- ⁵ Kërkesa sipas vendimit
- ⁶ 1. FURNIZIM ME PAJISJE PER PASTRIMIN E KRYEQYTETIT në vlerë prej, 400 000€; 2. SHERBIMET E TRANSPORTIT PUBLIK NE KOMUNEN E PRISHTINES në vlerë prej 371 141,37€; 3. FURNIZIM ME PAJISJE PER PASTRIMIN E KRYEQYTETIT në vlerë prej 266 432,68€; 4. RENOVIMI DHE PERMISIMI I INFRASTRUKTURES SE OBJEKTEVE TE KPSH-SE në vlerë prej 257 294,04€; 5. NDERTIMI I RRETHOJAVE PER SIGURI DHE MOBILITET në vlerë prej 250 410€; 6. FURINIZIM ME NAFTE PER OBJEKTET SHKOLLORE në vlerë prej 121 906,92€; 7. RIKONSTRUMI I RRUGEVE MIC SOKOLI DHE 27 NENTORI në vlerë prej 109 279,36€; 8. INVESTIMI DHE RREGULLIMI I HAPERSIRAVE PUBLIKE FAZA 2 në vlerë prej 195 837€; 9. NDERTIMI I RRUGES NE RADASHEVC në vlerë prej 56 272,72€; 10. MENAXHIMI I QENDRES PER TRAJTIMIN E QENVE ENDACAK-BLERJA E 2 PICKUP VETURA PER KAPJEN E QENVE në vlerë prej 50 000€; dhe 11. VENDOSJA E KAMERAVE NE KRYEQYTET në vlerë prej 99 998,46€.
- ⁷ 1. NDERTIMI I ISHULLIT URBAN ARBERI-PALLATI I RINISE -15% AVANC, 500 000€; 2. NDERTIMI I RRUGES A PJESA E PARE, 478 335,82€; 3. RENOVIMI I INSTITUCIONEVE EDUKATIVO ARSIMORE-BYFET, 250 031,13€; 4. INTERVENIME INFRASTRUKTURORE LLOT4, 199 784,77 €; 5. IMPLEMENTIMI I PLANIT TE MOBILITETIT, 187 261,29€; 6. RENOVIMI DHE PERMISIMI I INFRASTRUKTURES SE OBJEKTEVE TE KPSH-SE, 257 294,04€; 7. NDERTIMI I RRETHOJAVE PER SIGURI DHE MOBILITET, 250 410€; 8. RENOVIMI I SHKOLLES SE MESME 7 SHTATORI, 140 113,80€; 9. RREGULLIMI I VARESAVE TE DESHMOREVE NE VITI TE MARECIT, 228 030,70€; 10. NDERTIMI I ANEKSET TE SHKOLLES PAVARSIA, 136 803,06€; 11. FURNIZME ME TABELA SMART PER INSTITUCIONET SHKOLLORE, 224 000€; 12. NDERTIMI I RRUGEVE PRUGOVC -LEBANE -BARILEVE, 116 646,77€; 13. VAZHDIMI I NDERTIMIT TE KOLEKTORIT NE KALABRI, 113 324,75€; 14. NDERTIMI I KRAHEVE TE RRUGES MUHARREM FEJZA, 61 638€; 15. NDERTIMI I SHKOLLES 7 SHTATORI, 42 541,65€; 16. RIKONSTRUIMI I RRUGES REXHEP LUCI DHE QAMIL HOXHA, 50 006,45€; 17. DEPERTIMI I VETERNIKUT PER KYQJEN E KANALZIMIT FEKAL DHE LIDHJEN ME KOLEKTORIN NE KALABRI-PJESA E RRUGES A, 164 474,23€; 18. NDERTIMI I STREHIMORES -PARKU I QENEVE PJESA 2, 120 012,33€; 19. TRAJTMI I MBETURINAVE NDERTIMORE LOTO-1, 79 995,54€; 20. #01242211 RENOVIMI PER QENDRA TE NDRYSHME SOCIALE NE LAGJEN KODRA E TRIMAVE TOPHANE QAFA AKTASH, 40 719,68€; 21. NDERTIMI I STREHIMORES - PARKU I QENEVE-NEGOCIUAR, 50 000€; 22. NDERTIMI I FUSHAVE SPORTIVE NE KOMUNEN E PRISHTINES-FUSHA NE HAJVALI, 40 000€; 23. NDERTIMI I TRIBUNES PER KLUBIN FUTBOLLISTIK KF RAMIZ SADIKU, 28 295,80€; 24. FURNIZIM ME KONTEJNERA PER MBETURINA, 137 494€; 25. HARTIMI I FIZIBILITETIT PER PROJEKTIN- ZGJEDHJA URBANO ARKITETONIKE E NDERLIDHJES SE LAGJES KALABARIA ME LAGJEN DARDANIA, 218429,80€; 26. SHERBIME KONTRAKTUESE-KONSULENCE PER THEMELIMIN E SHERBIMIT TE ARKITETIT TE KRYEQYTETIT, 100,000€; 27. DIGITALIZIMI I PROCESEVE EDUKATIVO - ARSIMORE, 42,500€; 28. DIGITALIZIMI I PROCESEVE EDUKATIVO -ARSIMORE, 36,935,20€; 29. SHERBIME KONSULENTE MULTIDICIPLINARPER TE PERGADITUR DIZAJNIN DHE MBIKQYRUR NDERTIMIN E NJE KOLEGJI TE RI PER ARTET PAMORE, 16,000€; 30. SHERBIME KONSULENTE MULTIDICIPLINARE PER TE PERGADITUR DIZAJNIN DHE MBIKQYR NDERTIMIN E NJE KOLEGJI TE RI PER ARTET PAMORE, 48,000€; dhe 31. DIGITALIZIMI I PROCESVE EDUKATIVO ARSIMORE, 23,000€.
- ⁸ 1. "Ndërtimi, zgjerimi dhe modernizimi i rrjetit të ndriqimit publik Lot 1" në vlerë të parashikuar prej 1,500,000€, me çmim të poentuar 937.08€. 2. "Pastrimi i objekteve shëndetësore të KPSH-së - Ritender" me vlerë prej 1,498,102,23€. 3. "Ofrimi i makinerisë shtesë për shërbimin e grumbullimit ,transportimit dhe deponimit të mbeturinave Komunale" me vlerë prej 1,000,000€. 4. "Furnizimi me ushqim për qentë endacak në pikat ushqyesë dë QTQE -Negociuar", 49,900€. 5. "Kuratori kulturor për organizime dhe manifestime të Kryeqytetit" me vlerë prej 700,000€. 6. "Pastrimi i objekteve edukativo arsimore" me vlerë prej 1,426,797€. 7. "Furnizime me material për punimin e rethojave për hapësirën e kontejnerëve për njësitë e QKMF-së" me vlerë prej 8,410€. 8. "Sigurimi i autoambulancave të QMU-së,TPL,TPL+,Kasko si dhe Kontrollimi teknik i tyre" në vlerë prej 7,386,17€.
- ⁹ Buxheti Final - buxheti i aprovar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ¹⁰ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ¹¹ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikat e mira.